

**Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020**

**KREU 1  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu I, Neni 4, Pika 1	Himni kombëtar këndohet nga nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë të hënën e parë të çdo muaji, para fillimit të mësimin dhe në raste ceremonish.		
Kreu I, Neni 4, Pika 2	Institucioni arsimor ka vendosur Flamurin Kombëtar të Republikës së Shqipërisë.		

**KREU II  
ARSIMI PARASHKOLLOR**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu II, Neni 5, pika 1	Kopshti ka zhvilluar aktivitetin e tij gjatë gjithë vitit kalendarik për fëmijët 3-6 vjeç, për çdo grup (me ose pa ushqim).		
Kreu II, Neni 5, Pika 2	Fëmija, që ditën e fillimit të vitit shkollor, ka mbushur 3, 4 ose 5 vjeç, është regjistruar përkatësisht në grupin e parë, të dytë, të tretë, sipas moshës që i përket.		
Kreu II, pika 5, Neni 3	Fëmija 6 vjeç ka qëndruar në kopsht deri një ditë para fillimit të klasës së parë.		
Kreu II, Neni 5, Pika 4	Klasat përgatitore janë ngritur pranë IA-së për fëmijët e moshës 5 vjeç, të cilët nuk kanë ndjekur kopshtin për arsye të ndryshme apo në vendbanimin e tyre nuk ka pasur kopsht.		
Neni II, Neni 5, Pika 5	Regjistrimi i fëmijëve në institucionin e arsimit parashkollor është bërë në të njëjtën periudhë me regjistrimin e fëmijëve në arsimin bazë, me përjashtim të fëmijëve të grupeve të para në kopshte, të cilët janë regjistruar në kopsht me mbushjen e moshës 3-vjeç.		
Kreu II, Neni 5 Pika 6	Regjistrimi i fëmijës në institucionin e arsimit parashkollor është bërë me deklaratën <i>tip</i> , të plotësuar nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.		
Kreu II, Neni 6, Pika 1	Kurrikula në arsimin parashkollor është mbështetur në këto dokumente: LAPU; Korniza Kurrikulare e		

	arsimit parashkollor; standardet e zhvillimit dhe të të nxëniet për fëmijët 3-6 vjeç; programet e arsimit parashkollor për çdo grup-moshë.		
Kreu II, Neni 6 Pika 2	Kopshti ka realizuar veprimtarinë e tij sipas udhëzimit për vitin shkollor të ministrit.		
Kreu II, Neni 6, Pika 3	Gjatë pushimeve, veprimtaria e kopshtit është planifikuar nga mësuesit në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve dhe është miratuar nga drejtori i institucionit arsimor.		
Kreu II, Neni 6, Pika 4	Mësuesi i arsimit parashkollor ka hartuar planin mësimor vjetor të veprimtarive të grupit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve, me qëllim që veprimtaritë që zhvillohen në kopsht dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën. Plani mësimor vjetor i grupit është miratuar nga drejtori i institucionit arsimor.		
Kreu II, Neni 6, Pika 5	Në arsimin parashkollor, vlerësimi i fëmijës është realizuar në përputhje me kornizën e vlerësimit.		

### KREU III ARSIMI BAZË

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu III, Neni 7, Pika 1	ZVA-ja dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë bashkëpunuar për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kreu III, Neni 7, Pika 2	Fëmija që ka mbushur moshën 6 vjeç brenda muajit që fillon viti përkatës shkollor, është përfshirë në detyrimin për ndjekjen e shkollës. Regjistrimi i fëmijës në klasën e parë është bërë në dy javët e fundit të muajit qershor, me përjashtim të rastit kur fëmija ka ndryshuar vendbanimin deri në ditën e fillimit të shkollës. Regjistrimi i fëmijës në klasën e parë është bërë me formularin e plotësuar nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.		
Kreu III, Neni 7, Pika 3	Drejtuuesi i IA-së ka verifikuar, nëpërmjet personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, dhe ka regjistruar, për vitin e pasardhës shkollor, nxënësit e klasave të tjera të arsimit bazë, brenda dy javëve të fundit të muajit qershor të vitit përkatës.		
Kreu III, Neni 7, Pika 4	Nxënësit janë regjistruar në institucionin arsimor publik		

	<p>që mbulon vendbanimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit.</p> <p>Harta e mbulimit të territorit, e miratuar nga NJVV-ja, është respektuar gjatë regjistrimit të nxënësve në klasën e parë.</p>		
Kreu III, Neni 7, Pika 5	<p>Në rastet kur drejtori i IA-së ka lënë pa regjistruar fëmijët e zonës së mbulimit, duke plotësuar kapacitetet e IA-së me fëmijë nga jashtë zonës që mbulon, pa miratimin e drejtorit të ZVA-së, ndaj tij është marrë masë disiplinore deri në “Largim nga detyra”.</p> <p>ZVA-ja ka monitoruar regjistrimin/transferimin e nxënësve në çdo institucion arsimor dhe ka njoftuar DRAP-in.</p>		
Kreu III, Neni 7, Pika 6	<p>Nxënësi, që sipas vetëdeklarimit të personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje, ka qëndrim të ligjshëm jashtë shtetit, nuk është përfshirë në detyrimin shkollor, për aq kohë sa ka qëndruar jashtë shtetit.</p>		
Kreu III, Neni 7, Pika 7	<p>Personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, me kërkesë drejtuar administratorit të njësisë administrative, ka kërkuar mosregjistrimin me detyrim të fëmijës në shkollë, për shkaqe të përligjura shëndetësore, deri në moshën 8 vjeç.</p>		
Kreu III, Neni 8, Pika 1	<p>Kur personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, ka kërkuar përsëritjen e klasës së parë, të dytë apo të tretë për fëmijën e tij, i ka paraqitur drejtorit të shkollës kërkesën me shkrim.</p>		
Kreu III, Neni 8, Pika 2	<p>Drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës në bashkëpunim me mësuesin, ka miratuar ndjekjen e së njëjtës klasë nga nxënësi dhe dokumentacioni është ruajtur në arkivin e IA-së sipas legjislacionit për arkivat.</p>		
Kreu III, Neni 8, Pika 3	<p>Përsëritja e klasës së parë, të dytë apo të tretë është bërë vetëm një herë dhe vetëm në njërën prej tyre.</p>		
Kreu III, Neni 9, Pika 1	<p>Kurrikula në arsimin bazë është mbështetur në këto dokumente: LAPU, Kornizën Kurrikulare të arsimit parauniversitar, programet lëndore, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>		
Kreu III, Neni 9, Pika 2	<p>Kurrikula në arsimin bazë është organizuar në kurrikul bërthamë dhe kurrikul me zgjedhje.</p>		
Kreu III, Neni 9, Pika 3	<p>Shkolla e arsimit bazë ka zhvilluar kurrikulën bërthamë të detyruar dhe të përbashkët, për të gjithë nxënësit.</p>		

Kreu III, Neni 9, Pika 4	Kurrikula me zgjedhje, si pjesë e kurrikulës së përgjithshme, është zgjedhur nga shkolla dhe është zhvilluar brenda kohës së planifikuar në planin mësimor, në përputhje me interesat, me nevojat e nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.		
Kreu III, Neni 10, Pika 1	Planifikimi i mësimdhënies në arsimin bazë ka përfshirë: planifikimin lëndor vjetor të ndarë në tri periudha, planifikimin për secilën periudhë dhe planifikimin ditor.		
Kreu III, Neni 10, Pika 2	Mësuesi, në fillim të vitit shkollor, ka dorëzuar në drejtorinë e shkollës planin vjetor të lëndës, i cili është një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe planin e periudhës së parë. Planet e periudhës së dytë dhe të tretë, janë dorëzuar para fillimit të secilës periudhë.		
Kreu III, Neni 10, Pika 3	Mësuesi, gjatë vitit, sipas rrethanave që i janë krijuar, ka bërë ndryshime në planin fillestar të periudhës, ndryshime të cilat janë miratuar nga drejtori i IA-së.		
Kreu III, Neni 11, Pika 1	Klasat e profilizuara në sport janë krijuar në disiplina të ndryshme sportive, sipas kërkesave të nxënësve, vetëm në fillim të vitit shkollor dhe pas miratimit nga DRAP-i.		
Kreu III, Neni 11, Pika 2	Drejtuesi i ZVA-së dhe/ose drejtori i shkollës 9-vjeçare ka kërkuar në DRAP hapjen e klasës së profilizuar në sport, vetëm nëse shkolla ka plotësuar kushtet e infrastrukturës dhe kriteret e mësimdhënies së personelit të edukimit fizik.		
Kreu III, Neni 11, Pika 3	DRAP-i ka shoqëruar vendimin për hapjen e klasës së profilizuar në sport në ministrinë përgjegjëse për arsimin, me informacion për: a) qëllimin e hapjes së klasës së profilizuar në sport; b) kushtet e infrastrukturës për zhvillimin e disiplinës sportive; c) personelin mësimor të specializuar në disiplinën sportive përkatëse; ç) bazën materiale dhe didaktike për zhvillimin e disiplinës sportive; d) numrin e nxënësve që do të përfshihen dhe ndarjen e tyre sipas disiplinave sportive.		
Kreu III, Neni 11, Pika 4	Krijimi i klasës së profilizuar në sport, referuar elementeve bazë teknike dhe fizike të nxënësve, është bërë pas përfundimit të arsimit fillor (AF), mbështetur në vullnetarizmin e nxënësve dhe të personave që		

	ushtrjnë përgjegjësinë prindërore.		
Kreu III, Neni 11, Pika 5	Krijimi i klasës së re të profilizuar në sport ka nisur nga klasa VI, për vitin shkollor përkatës, për të vijuar në vitet në vazhdim deri në klasën IX.		
Kreu III, Neni 11, Pika 6, Gërma a	Klasa e profilizuar në sport është krijuar në një disiplinë të vetme sportive.		
Kreu III, Neni 11, Pika 6, Gërma b	Klasa e profilizuar në sport është krijuar në dy disiplina sportive të kombinuara (djemtë në një disiplinë, vajzat në një disiplinë tjetër.		
Kreu III, Neni 11, Pika 7	Drejtori i shkollës 9-vjeçare ka hartuar ngarkesën mësimore për mësuesin e edukimit fizik, referuar kuadrin ligjor në fuqi.		

#### **KREU IV ARSIMI I MESËM I LARTË**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu IV, Neni 12, Pika 1	Regjistrimi në klasën e dhjetë është bërë në dy javët e para të muajit korrik, me plotësimin e formularit nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.		
Kreu IV, Neni 12, Pika 2	Janë regjistruar në klasën e dhjetë të gjimnazit vetëm nxënësit që u përkasin shkollave të arsimit bazë të zonës së gjimnazit. Nxënësit janë regjistruar në gjimnazin publik sipas zonës së gjimnazit, sipas planifikimit paraprak të ZVA-së. Zona e gjimnazit dhe planifikimi paraprak janë respektuar me përpikëri nga drejtori i IA-së. Në rastet kur IA-ja ka lënë pa regjistruar nxënës të zonës, duke plotësuar kapacitetet e saj me nxënës nga jashtë zonës që mbulon, pa miratimin e drejtorit të ZVA-së, ndaj drejtorit të IA-së është marrë masë disiplinore deri në “Largim nga detyra”. ZVA-ja ka monitoruar regjistrimin/transferimin e nxënësve në çdo institucion arsimor dhe ka njoftuar DRAP-in.		
Kreu IV, Neni 13, Pika 1	Pranimet në shkollën e arsimit të mesëm të orientuar (artistike, sportive, për gjuhët e huaja dhe shkolla për fusha të tjera të nxëni) janë bërë sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të ministrit.		
Kreu IV, Neni 13, Pika 2	Shkolla e arsimit të mesëm të orientuar ka pranuar nxënës edhe nga NJVV të tjera, të cilat nuk kanë shkolla të arsimit të mesëm të orientuar.		

Kreu IV, Neni 13, Pika 3	Regjistrimi i nxënësve në shkollën e arsimit të mesëm të orientuar është bërë me deklaratën tip nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje. Kur një nxënës nuk është paraqitur në shkollë për regjistrim, brenda 5 (pesë) ditëve nga fillimi i vitit shkollor për shkaqe të pajustificuara, shkolla ka regjistruar nxënësin tjetër, sipas radhës në listë.		
Kreu IV, Neni 14, Pika 1	Nxënësit janë pranuar pa konkurs në gjimnaz, në shkollën për gjuhët e huaja dhe në shkollën për fusha të tjera të të nxëni.		
Kreu IV, Neni 14, Pika 2	Kur në shkollën për gjuhët e huaja/për fusha të tjerë të të nxëni, ka pasur kërkesa më të mëdha se numri i nxënësve të planifikuar, nxënësit janë përzgjedhur sipas mesatares së notave të provimeve kombëtare të arsimit bazë, të rumbullakosur me një shifër pas presjes dhjetore.		
Kreu IV, Neni 14, Pika 3	Kur numri i aplikantëve është më i madh se kapaciteti i shkollës për gjuhët e huaja/për fusha të tjerë të të nxëni, drejtori i IA-së ka dërguar në ZVA kërkesën me shkrim për rritjen e numrit të pranimeve në shkollë.		
Kreu IV, Neni 15, Pika 1	Shkolla artistike/shkolla sportive ka pranuar nxënësit vetëm me konkurs.		
Kreu IV, Neni 15, Pika 2	Pranimet në shkollën artistike/shkollën sportive janë bërë sipas udhëzimit të ministrit.		

## KREU V KURRIKULA E GJIMNAZIT

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu V, Neni 16, Pika 1	Kurrikula e gjimnazit është bazuar në LAPU dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kreu V, Neni 16, Pika 2	Zbatimi i kurrikulës në gjimnaz është mbështetur në dokumentet kurrikulare dhe udhëzimet e ministrit.		
Kreu V, Neni 16, Pika 3	Kurrikula e gjimnazit është organizuar në kurrikul bërthamë, kurrikul me zgjedhje dhe kurrikul në bazë shkolle.		
Kreu V, Neni 16, Pika 4	Gjimnazi ka zhvilluar kurrikulën bërthamë, të detyruar dhe të njëjtë, për të gjithë nxënësit.		
Kreu V, Neni 16, Pika 5	Gjimnazi ka organizuar kurrikulën me zgjedhje, duke zgjedhur lëndë/module që nuk zhvillohen në kurrikulën bërthamë.		
Kreu V, Neni 16, Pika 6	Kurrikula në bazë shkolle nuk ka qenë e detyruar për nxënësin. Ajo i ka mundësuar nxënësit të zhvillojë aftësitë nëpërmjet moduleve kurrikulare, projekteve		

	ndërkurrikulare apo veprimtarive të tjera shkollore.		
Kreu V, Neni 16, Pika 7, Gërma a	Shkolla (gjimnazi) i ka siguruar secilit nxënës kurrikulën bërthamë.		
Kreu V, Neni 16, Pika 7, Gërma b	Shkolla (gjimnazi) i ka siguruar secilit nxënës numrin e orëve mësimore të kurrikulës me zgjedhje.		
Kreu V, Neni 16, Pika 7, Gërma c	Shkolla (gjimnazi) i ka siguruar secilit nxënës numrin e orëve të shërbimit komunitar.		
Kreu V, Neni 17, Pika 1, Gërma a	Drejtori i gjimnazit, mësuesi kujdestar dhe ekipet lëndore kanë informuar nxënësit për listën e lëndëve/moduleve me zgjedhje që ofron shkolla për secilën klasë.		
Kreu V, Neni 17, Pika 1, Gërma b	Drejtori i gjimnazit, mësuesi kujdestar dhe ekipet lëndore kanë siguruar formularët përkatës për plotësim për secilin nxënës.		
Kreu V, Neni 17, Pika 2	Drejtori i gjimnazit ka miratuar, brenda muajit gusht, planin e kurrikulës me zgjedhje për çdo lëndë/modul dhe ka përcaktuar mësuesit që do t'i zhvillojnë.		
Kreu V, Neni 17, Pika 3	Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje në gjimnaz janë kryer sipas udhëzimit përkatës të ministrit.		
Kreu V, Neni 17, Pika 4	Nxënësi në gjimnaz nuk është lejuar ta ndërrojë lëndën me zgjedhje gjatë vitit shkollor.		
Kreu V, Neni 18, Pika 1	Planifikimi i mësimdhënies në gjimnaz ka përfshirë: planifikimin vjetor lëndor të ndarë në periudha, planifikimin për secilën periudhë dhe planifikimin ditor.		
Kreu V, Neni 18, Pika 2	Mësuesi, në fillim të vitit shkollor, ka dorëzuar në drejtorinë e gjimnazit planin vjetor të lëndës, i cili është një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orës mësimore, si dhe planin për periudhën e parë. Planet e periudhës së dytë dhe të tretë janë dorëzuar para fillimit të secilës periudhë.		
Kreu V, Neni 18, Pika 3	Mësuesi, gjatë vitit, sipas rrethanave që i janë krijuar, ka bërë ndryshime në planin fillestar të periudhës, ndryshime të cilat janë miratuar nga drejtori i gjimnazit.		

## KREU VI VLERËSIMI I NXËNËSIT NË KLASAT I-XII

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu VI, Neni 19, Pika 1	Gjatë procesit të vlerësimit janë mbledhur të dhëna dhe është gjykuar për vlerën e arritjes së rezultateve të të nxënësve, duke u bazuar në nivelet e arritjes.		
Kreu VI, Neni 19, Pika 2	Vlerësimi ka mbështetur të nxënësve dhe përparimin e nxënësve.		
Kreu VI, Neni 20, Pika 1	Vlerësimi i nxënësve në klasat I-III është bërë me		

	përshkrim.		
Kreu VI, Neni 20, Pika 2	Vlerësimi i nxënësit për arritjen e kompetencave të fushave/lëndëve të të nxënit në klasat IV-XII është bërë me notë dhe është realizuar me: a) vlerësimin e vazhduar; b) vlerësimin me test/me detyrë përmbledhëse; c) vlerësimin e portofolit të nxënësit me notë.		
Kreu VI, Neni 20, Pika 3	Vlerësimi përfundimtar është kryer në përfundim të vitit shkollor me notë, referuar niveleve të arritjes.		
Kreu VI, Neni 20, Pika 4, Gërma a	Nota përfundimtare përfshin notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudhat.		
Kreu VI, Neni 20, Pika 4, Gërma b	Nota përfundimtare përfshin notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për tri periudhat.		
Kreu VI, Neni 20, Pika 4, Gërma c	Nota përfundimtare përfshin notën vjetore të vlerësimit të portofolit të nxënësit për të tri periudhat.		
Kreu VI, Neni 20, Pika 5	Mësuesi ka mbajtur të dhëna gjatë gjithë vitit shkollor për vlerësimin e nxënësit. Vlerësimi i vazhduar, testet/detyrat përmbledhëse dhe portofoli i nxënësit janë ruajtur në shkollë.		
Kreu VI, Neni 21, Pika 1	Drejtorja e IA-së ka zhvilluar testime me short për të gjitha lëndët ose fushat e të nxënit dhe të gjitha klasat, për të evidentuar arritjet e nxënësve në një periudhë të caktuar.		
Kreu VI, Neni 21, Pika 2	Drejtorja e IA-së, pas këshillimit me këshillin e mësuesve, ka caktuar procedurat e shortit, periudhën e realizimit dhe numrin e testimeve.		
Kreu VI, Neni 21, Pika 3	Testet janë korrigjuar nga ekipi lëndor, i kryesuar nga një prej drejtuesve të IA-së.		
Kreu VI, Neni 21, Pika 4	Notat e nxënësve në testimet me short janë konsideruar si nota të testeve ose të detyrave përmbledhëse për periudhën përkatëse.		
Kreu VI, Neni 22, Pika 1	Nxënësi është vlerësuar në sesionin e dytë, kur ka qenë jokalues në një ose dy lëndë.		
Kreu VI, Neni 22, Pika 2	Mësuesi i klasave IV-V i ka dhënë nxënësit detyra konkrete për t'i zhvilluar gjatë verës dhe në sesionin e dytë ka vendosur kalimin ose jo të nxënësit.		
Kreu VI, Neni 22, Pika 3	Mësuesi i arsimit të mesëm i ka dhënë nxënësit detyra konkrete dhe një program orientues për t'u parapërgatitur në sesionin e dytë. Nxënësi i është nënshtruar provimit me shkrim të hartuar nga mësuesi i lëndës dhe të miratuar nga ekipi lëndor. Vlerësimi i tij është bërë nga komisioni, i ngritur nga drejtori, i përbërë nga tre anëtarë.		
Kreu VI, Neni 22, Pika 4	Drejtori i IA-së ka caktuar një datë tjetër, brenda sesionit të dytë, për nxënësin që nuk është paraqitur në provim për		



	arsye të dokumentuara ligjërisht.		
Kreu VI, Neni 23, Pika 1	Vendimin për përcaktimin jokalues të nxënësit në një lëndë, me përjashtim të klasave I-III, e ka marrë mësuesi i klasës/lëndës.		
Kreu VI, Neni 23, Pika 2, Gërma a	Nxënësi ka mbetur në klasë, kur ka qenë jokalues në të paktën tri lëndë.		
Kreu VI, Neni 23, Pika 2, Gërma b	Nxënësi ka mbetur në klasë, kur ka qenë jokalues të paktën në një lëndë në sesionin e dytë.		
Kreu VI, Neni 23, Pika 2, Gërma c	Nxënësi ka mbetur në klasë, kur ka pasur masë disiplinore “Ulje e notës në sjellje” dhe nuk e ka përmirësuar atë deri në përfundim të vitit mësimor.		
Kreu VI, Neni 23, Pika 2, Gërma ç	Nxënësi ka mbetur në klasë, kur ka figuruar i paklasifikuar për shkak të mungesave.		
Kreu VI, Neni 23, Pika 3	Nxënësi mbetës ka përsëritur klasën në vitin shkollor pasues, kur ka qenë brenda moshës së përcaktuar në LAPU.		

## KREU VII INSTITUCIONET ARSIMORE

Baza ligjore	Kreu	Po/Jo	Komente
Kreu VII, Neni 24, Pika 1	Institucionet arsimore (me kohë të plotë apo me kohë të pjeshme) e zhvillojnë veprimtarinë pesë ditë në jave, nga e hëna deri të premte.		
Kreu VII, Neni 24, Pika 2	Drejtori i IA-së publike ka informuar menjëherë ZVA-në për çdo rënie/rritje të numrit të nxënësve që ndikon në hapjen/mbylljen e klasave/shkollave vartëse.		
Kreu VII, Neni 24, Pika 3	Drejtori i IA-së ka marrë miratimin në ZVA për funksionimin e shkollës me dy ndërresa. Mësimi (si rregull) në shkollën e ndërresës së parë fillon në orën 8.00. Në ndërresën e dytë dhe për arsimin me kohë të pjeshme, ora e fillimit të mësimit është miratuar nga titullari i ZVA-së.		
Kreu VII, Neni 24, Pika 4	Drejtori i IA-së ka caktuar mësues ditor për të lehtësuar mbarëvajtjen e shkollës. Detyrat e mësuesit ditor janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të shkollës.		
Kreu VII, Neni 24, Pika 5	Drejtuesi i IA-së, në kushte të rënduara të motit, të terrenit, ose për arsye të transportit rrugor, ka vendosur ndryshimin përkohësisht të orës së fillimit të mësimit, me miratim të titullarit të ZVA-së.		
Kreu VII, Neni 24, Pika 6	Ndërmjet orëve të mësimit, pushimi është caktuar 5 ose 10 minuta.		

	Këshilli i mësuesve ka vendosur kohën kur shkolla do të bëjë pushimin e madh, i cili zgjat 20 deri 30 minuta.		
Kreu VII, Neni 24, Pika 7	Kohëzgjatja e orës mësimore në shkollë është 45 minuta.		
Kreu VII, Neni 24, Pika 8	Ora e mësimi nuk cenohet, me përjashtim të rasteve të veçanta, kur cenohet shëndeti dhe siguria fizike e nxënësve. Organizimi i orarit të shkollës për orë të njëpasnjëshme është vendosur nga drejtori i shkollës dhe këshilli i mësuesve.		
Kreu VII, Neni 25, Pika 1	Ndërprerja e veprimtarisë së institucionit arsimor (në të gjithë vendin ose në zona të caktuara) është bërë vetëm nga ministria përgjegjëse për arsimin ose është propozuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore apo nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe është miratuar me urdhër të posaçëm të ministrit.		
Kreu VII, Neni 26, Pika 1	Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore janë planifikuar nga drejtori i IA-së në bashkëpunim me këshillin e mësuesve, bazuar në udhëzimin e vitit shkollor, si dhe me miratim të ZVA-së.		
Kreu VII, Neni 26, Pika 2, Gërma a	Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore kanë përfshirë veprimtari social-kulturore, artistike, sportive, letrare, shkencore, mjedisore.		
Kreu VII, Neni 26, Pika 2, Gërma b	Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore kanë përfshirë ekskursionet, vizita dhe konkurse që plotësojnë e thellojnë kurrikulën.		
Kreu VII, Neni 26, Pika 2, Gërma c	Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore kanë përfshirë festime të ditëve të shënuara.		
Kreu VII, Neni 26, Pika 3	Veprimtaritë plotësuese dhe ato jashtëshkollore që janë zhvilluar në nivel IA-je, janë pasqyruar në një dokument, ku janë shënuar synimi i veprimtarisë, pjesëmarrja dhe është përshkruar përmbledhtas ecuria e saj.		
Kreu VII, Neni 26, Pika 4	Veprimtaritë plotësuese, ato jashtëshkollore dhe veprimtari të tjera, si olimpiadat, janë zhvilluar pa cenuar orët mësimore të parashikuara në planin mësimor.		
Kreu VII, Neni 26, Pika 5	Pjesëmarrja e nxënësve në këto veprimtari ka qenë vullnetare dhe gjithëpërfshirëse.		
Kreu VII, Neni 26, Pika 6	Veprimtaritë e nxënësve kanë përmbushur kushtet e sigurisë, të ruajtjes së jetës dhe të shëndetit të tyre.		
Kreu VII, Neni 27, Pika 1	Në ekskursionet me nxënësit, janë siguruar kushtet e sigurisë dhe të ruajtjes së shëndetit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë.		
Kreu VII, Neni 27, Pika 2	Drejtori i IA-së ka paraqitur në ZVA, planin vjetor të ekskursioneve, që në fillim të vitit mësimor dhe të paktën dy javë para datës së çdo ekskursioni, të dhënat dhe dokumentet e mëposhtme:		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>a) qëllimin e ekskursionit;</li> <li>b) përshkrimin përmbledhës të etapave të ekskursionit;</li> <li>c) miratimin me shkrim të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore;</li> <li>ç) dokumentet e agjencisë për transportin e nxënësve (licenca e shoferit, dokumenti i gjendjes teknike të automjetit);</li> <li>d) të dhënat për ushqimin;</li> <li>dh) kushtet e fjetjes;</li> <li>e) burimet e financimit;</li> <li>ë) shpenzimet.</li> </ul>		
Kreu VII, Neni 27, Pika 3	Titullari i ZVA-së ka miratuar me shkrim kryerjen e ekskursionit.		
Kreu VII, Neni 27, Pika 4	Shpenzimet financiare për ekskursionet me nxënësit janë mbuluar me dëshirë nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre në masën jo më shumë se tarifa e miratuar, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Drejtori i IA-së ka hartuar dokumentacionin e nevojshëm të shpenzimeve financiare për ekskursionet.		
Kreu VII, Neni 27, Pika 5	Shpenzimet financiare për ekskursione të punonjësve arsimorë janë mbuluar nga vetë punonjësit arsimorë.		
Kreu VII, Neni 27, Pika 6	IA-ja nuk ka përdorur për ekskursione burimet financiare të saj, si dhurime, donacione, kontribute të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve ose fonde të siguruara nga institucioni nëpërmjet shërbimeve për të tretët.		
Kreu VII, Neni 28, Pika 1	IA-ja publike ka përfituar fonde financiare dhe mbështetje materiale nga dhurues ose donatorë, sipas legjislacionit në fuqi.		
Kreu VII, Neni 28, Pika 2	IA-ja publike ka siguruar të ardhura nga shërbime për të tretët, sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me fushën e veprimtarisë së saj.		
Kreu VII, Neni 28, Pika 3	NJVV-ja ka dhënë me qira mjedise të IA-së për veprimtari social-kulturore, artistike dhe sportive. jashtë kohës që zhvillon veprimtarinë IA-ja dhe pa cenuar standardet e veprimtarisë mësimore, pas konfirmimit të drejtorit të shkollës dhe garantimit të pastërtisë së ambienteve dhe grafikut të aktiviteteve.		
Kreu VII, Neni 28, Pika 4	Aspektet e tjera financiare janë trajtuar sipas akteve ligjore në fuqi.		

**KREU VIII**  
**SHËRBIMI PSIKO-SOCIAL NË INSTITUCIONET ARSIMORE DHE OFICERI I**  
**SIGURISË**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu VIII, Neni 29, Pika 1	Shërbimi psiko-social ka vlerësuar gjendjen psiko-sociale të nxënësve me probleme të të nxënësve ose të sjelljes dhe, në bashkëpunim me mësuesit, drejtuesit e IA-ve dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve, ka planifikuar dhe ka realizuar shërbime të përshtatshme që ndihmojnë zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësit.		
Kreu VIII, Neni 29, Pika 2, Gërma a	Shërbimi psiko-social u është ofruar nxënësve të IA-ve publike. Në IA-të private, shërbimi psiko-social është ofruar nga vetë institucioni.		
Kreu VIII, Neni 29, Pika 2, Gërma b	Shërbimi psiko-social u është ofruar mësuesve, në rastet kur është kërkuar prej tyre, ose kur drejtori i IA-së e ka parë të arsyeshme.		
Kreu VIII, Neni 29, Pika 3	Shërbimi psiko-social ka mbështetur personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe ka bashkëpunuar me ta për zgjidhjen e situatave dhe në raste nevojë të kërkuara prej tyre.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 1	ZVA-ja ka organizuar ngritjen e Njesisë së Shërbimit Psiko-Social, sipas urdhrit për shërbimin psiko-social, të miratuar nga ministri.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 2	NjShPS -ja është e përbërë nga psikologë dhe punonjës socialë.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 3	Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në NjShPS është vendosur sipas urdhrit të ministrit për normat e punonjësve psiko-socialë në IA-të publike.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 4, Gërma a	Drejtuesi i njesisë së shërbimit psiko-social ka hartuar planin vjetor të njesisë, i cili është miratuar nga titullari i ZVA-së.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 4, Gërma b	Drejtuesi i NjShPS-së ka organizuar mbledhjet mujore të njesisë.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 4, Gërma c	Drejtuesi i NjShPS-së ka bashkëpunuar me NJMF-në, për të trajtuar çështje të abuzimit dhe mbrojtjes së fëmijëve.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 4, Gërma ç	Drejtuesi i NjShPS-së ka komunikuar me drejtuesin e IA-së dhe ZVA-së për rastet e fëmijëve në rrezik dhe me vështirësi sociale dhe ekonomike.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 4, Gërma d	Drejtuesi i NjShPS-së ka informuar me shkrim titullarin e ZVA-së dhe IA-së për çdo rast të provuar apo të dyshuar për abuzimin e nxënës-it/-ve.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika	Drejtuesi i NjShPS-së ka mbikëqyrur veprimtarinë e		

4, Gërma dh	psikologëve/ punonjësve socialë të njësisë përkatëse.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 4, Gërma e	Drejtuesi i NjShPS-së ka takuar rregullisht punonjës arsimorë, nxënës që përfitojnë nga shërbimi i psikologëve dhe i punonjësve socialë, si dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 4, Gërma ë	Drejtuesi i NjShPS-së ka hartuar raporte gjashtëmujore për titullarin e ZVA-së, ku ka përshkruar veprimtarinë e NjShPS-së, si dhe ka propozuar përmirësime të shërbimit psiko-social.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 5	Shërbimi psiko-social ka mbledhur dhe ka përpunuar të dhëna për: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) ndryshime të sjelljes së nxënësve;</li> <li>b) nivelin social dhe ekonomik të nxënësve;</li> <li>c) marrëdhëniet me shokët;</li> <li>ç) marrëdhëniet me mësuesit;</li> <li>d) komunikimin dhe marrëdhëniet me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve;</li> <li>dh) dukurinë e bullizmit në IA;</li> <li>e) mënyrën se si e kalojnë nxënësit kohën e lirë;</li> <li>ë) varësinë e nxënësve ndaj internetit;</li> <li>f) varësinë ndaj pirjes së duhanit, alkoolit dhe drogave etj.</li> </ul>		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 6	Punonjësi psiko-social ka njoftuar mësuesin kujdestar të klasës së nxënësit dhe drejtuesit e IA-së për të dhënat që grumbullon për nxënësin.		
Kreu VIII, Neni 30, Pika 7	Të dhënat për nxënësin janë bërë pjesë e raporteve të paraqitura në ZVA.		
Kreu VIII, Neni 31, Pika 1	Psikologu/punonjësi social, në bashkëpunim me mësuesit dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, ka identifikuar e ka vlerësuar sa më herët, nxënësit me probleme të sjelljes dhe me vështirësi në të nxënë, si dhe ka hartuar e ka zbatuar për këta nxënës plane individuale parandaluese ose rehabilituese.		
Kreu VIII, Neni 31, Pika 2	Psikologu/punonjësi social ka ndihmuar punonjësit arsimorë, personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe nxënësit për parandalimin ose eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj punonjësve		
Kreu VIII, Neni 31, Pika 3	Psikologu/punonjësi social ka informuar punonjësit e IA-ve për zhvillimet moshës tipike dhe problemet tipike që hasin nxënësit gjatë të mësuarit dhe të të nxënit.		
Kreu VIII, Neni 31, Pika 4	Psikologu/punonjësi social ka ndihmuar mësuesit kujdestarë dhe mësuesit lëndorë për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e IA-ve.		
Kreu VIII, Neni 31, Pika 5	Psikologu ka administruar dhe ka interpretuar teste psikologjike.		

Kreu VIII, Neni 31, Pika 6	Psikologu/punonjësi social ka plotësuar dosjet individuale për nxënësit që përfitojnë shërbim psiko-social.		
Kreu VIII, Neni 31, Pika 7	Psikologu/punonjësi social ka raportuar me shkrim te drejtuesi i NjShPS dhe te drejtori i IA-së për çdo rast të provuar apo të dyshuar për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimorë dhe nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit.		
Kreu VIII, Neni 32, Pika 1	Njësia e shërbimit psiko-social ka kryer zhvillimin e brendshëm profesional, sipas planit vjetor të miratuar nga titullari i ZVA-së dhe zhvillimin e jashtëm profesional, sipas akteve nënligjore në fuqi.		
Kreu VIII, Neni 32, Pika 2	Testet psikologjike, vlerësimet, këshillimet apo ndërhyrjet e tjera me natyrë psikologjike dhe/ose sociale dhe çdo komunikim tjetër i psikologut/punonjësit social janë realizuar pas miratimit me shkrim të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kreu VIII, Neni 32, Pika 3	Psikologu/punonjësi social ruan në dosje informacionin, e marrë për shkak të detyrës, për nxënësit dhe familjet e tyre. Dosja është siguruar nga përdorimi i saj prej personave të paautorizuar.		
Kreu VIII, Neni 32, Pika 4	Psikologu/punonjësi social u ka dhënë mundësi për leximin e dosjes së nxënësit) vetëm personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe nxënësit mbi moshën 16 vjeç.		
Kreu VIII, Neni 32, Pika 5	Psikologu/punonjësi social nuk ka ndarë të dhënat e dosjes së nxënësit me persona të tjerë në IA dhe jashtë tij.		
Kreu VIII, Neni 32, Pika 6	Kur nxënësi është transferuar në një IA tjetër, drejtori i IA-së i ka dorëzuar drejtorit të institucionit të ri kopje të dosjes, të nënshkruar prej tij dhe prej punonjësit psiko-social përkatës.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 1	Oficeri i sigurisë ka monitoruar mjedisin e IA-së në mënyrë të vazhdueshme rreth situatave të dyshimta, hyrjes së personave të paautorizuar apo cenimit të pronës së IA-së.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 2	Oficeri i sigurisë ka parandaluar dhe ka menaxhuar rastet emergjente dhe të dhunës në IA.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 3	Oficeri i sigurisë ka kontribuar në ndërgjegjësimin e nxënësve për rregullat, ligjin dhe drejtësinë.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 4	Oficeri i sigurisë, sa herë i është kërkuar nga drejtori i IA-së, ka marrë pjesë në takimet me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe në takime periodike të stafit mësimor të IA-së, për evidentimin e problematikave dhe diskutimin e zgjidhjeve për sigurinë në shkollë.		

Kreu VIII, Neni 33, Pika 5	Oficeri i sigurisë ka bashkëpunuar me drejtorinë e IA-së dhe stafin mësimor për të garantuar dhe për të krijuar një mjedis të sigurt në shkollë.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 6	Oficeri i sigurisë ka ndërvepruar me drejtorinë e IA-së dhe stafin e saj, duke ndërhyrë dhe parandaluar në rastet e thyerjes së disiplinës, menaxhimit të krizave dhe në rastet e emergjencave.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 7	Oficeri i sigurisë ka hartuar një plan sigurie të IA-së, duke përcaktuar rreziqet e mundshme, daljet emergjente dhe duke minimizuar burimet e aksidenteve.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 8	Oficeri i sigurisë ka bashkëpunuar me agjencitë ligjzbatuese dhe ka shërbyer si ndërlidhës mes Policisë së Shtetit dhe komunitetit, për të parandaluar veprat kriminale.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 9	Oficeri i sigurisë ka evidentuar situatat e parregullta të rendit dhe të sigurisë publike, brenda dhe jashtë perimetrit të IA-së dhe ka njoftuar oficerin e policimit në komunitet.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 10	Oficeri i sigurisë ka menaxhuar dhe ka raportuar situatat që kanë paraqitur rrezikshmëri në mjediset e IA-së.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 11	Oficeri i sigurisë ka bashkëpunuar dhe ka ndërmjetësuar me punonjësin e shërbimit psiko-social në situata konfliktesh brenda mjediseve të IA-së.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 12	Oficeri i sigurisë u ka ofruar asistencë personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve, për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe për menaxhimin e konflikteve.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 13	Oficeri i sigurisë është përshtatur me komunitetin e zonës në të cilën ndodhet IA-ja ku ushtron veprimtarinë e tij.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 14	Oficeri i sigurisë ka realizuar takime informuese me stafin mësimor, me nxënësit dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre, për rastet që paraqesin rrezikshmëri shoqërore, me qëllim që të rrisë ndërgjegjësimin qytetar.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 15	Oficeri i sigurisë ka hartuar raporte javore, vjetore dhe të situatës/ incidentit, të cilat ia ka dërguar Zyrës për Koordinimin dhe Monitorimin.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 16	Oficeri i sigurisë ka raportuar në mënyrë periodike tek autoritetet përgjegjëse (institucionet arsimore vendore, ministria përgjegjëse për arsimin), sipas formateve të miratuara të raportimit.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 17	Oficeri i sigurisë ka zbatuar parimet etike për ruajtjen e konfidencialitetit të rasteve të veçanta dhe të ndjeshme.		
Kreu VIII, Neni 33, Pika 18	Oficeri i sigurisë ka zhvilluar kontrolle fizike të nxënësve ose të mjediseve, vetëm në raste emergjente ose me vendim të drejtorit të IA-së.		

**KREU IX**  
**KOMISIONI I ETIKËS DHE SJELLJES NË INSTITUCIONIN ARSIMOR**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu IX, Neni 34, Pika 1	Sjellja etike e punonjësit arsimor është bazuar në parimet, vlerat dhe standardet e përcaktuara në Kodin e Etikës së Mësuesit, LAPU, legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës dhe Kontratën Kolektive të punës.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 2	Sjellja etike e punonjësit arsimor është në funksion të përmbushjes së pritshmërive të nxënësve dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre, ku përmbushja e detyrimeve ndaj tyre është mbi interesat e çdo punonjësi arsimor.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 3	Punonjësi arsimor ka përmbushur dimensionin etik në përgjithësi dhe atë të integritetit në veçanti.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 4	Punonjësi arsimor ka zbatuar standardet dhe kërkesat etike në nivelin që kërkohet në Kodin e Etikës. Devijimet nga niveli i kërkuar në Kodin e Etikës janë konsideruar shkelje të këtij kodi.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 5	Punonjësi arsimor mban përgjegjësi për reputacionin e IA-së dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij është model i integritetit.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 6	Punonjësi arsimor ka ushtruar përgjegjësitë e tij duke u mbështetur në: a) përkushtimin ndaj nxënësit; b) përkushtimin ndaj profesionit; c) përkushtimin ndaj mjedisit arsimor.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 7, Gërma a	Punonjësi arsimor ka zbatuar rregullat e sjelljes etike, duke vepruar me ndershmëri, profesionalizëm, objektivitet, përkushtim e paanshmëri, në zbatimin e detyrave të ngarkuara.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 7, Gërma b	Punonjësi arsimor ka shmangur çdo formë të diskriminimit dhe ka kontribuar për zbatimin e një politike të mundësive të barabarta për të gjithë.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 7, Gërma c	Punonjësi arsimor ka respektuar standardet bazë të sjelljes dhe komunikimit brenda dhe jashtë mjedisit të IA-së.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 7, Gërma ç	Punonjësi arsimor ka kontribuar në zbatimin e një politike të hapur komunikimi, ka inkurajuar dialogun, diskutimet e hapura dhe pa paragjykime.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 7, Gërma d	Punonjësi arsimor nuk ka nxjerrë apo nuk ka përdorur informacione konfidenciale, të siguruar nëpërmjet punës në IA.		
Kreu IX, Neni 34,	Punonjësi arsimor ka shmangur pjesëmarrjen në veprimtaritë		



Pika 7, Gërma dh	që përbëjnë konflikt interesi. Drejtori i IA-së apo punonjësi arsimor i autorizuar prej tij, ka komunikuar me medien, si dhe ka përdorur mjetet e komunikimit digjital për të bërë publike informacione që lidhen me IA-në dhe veprimtarinë mësimore që zhvillohet aty vetëm me leje nga titullari i ZVA-së, i cili ka marrë paraprakisht konfirmimin nga titullari i DRAP-it.		
Kreu IX, Neni 34, Pika 8	IA-ja nuk ka lejuar të hyjnë persona të paautorizuar në ambientet e saj.		
Kreu IX, Neni 35	Punonjësi arsimor paraqitet në shkollë me veshje dhe paraqitje serioze të përshtatshme për vendin dhe natyrën e punës.		
Kreu IX, Neni 35, Gërma a	Punonjësi arsimor vesh këmisha dhe bluza serioze.		
Kreu IX, Neni 35, Gërma b	Punonjësi arsimor nuk paraqitet në shkollë me veshje të lirshme ose të hapura sa të ekspozojnë trupin.		
Kreu IX, Neni 35, Gërma c	Punonjësi arsimor nuk paraqitet në shkollë me veshje që i duket trupi, ndërmjet veshjeve të sipërme dhe të poshtme.		
Kreu IX, Neni 35, Gërma ç	Punonjësi arsimor nuk vesh në shkollë pantallona të shkurtra.		
Kreu IX, Neni 35, Gërma d	Punonjësi arsimor nuk mban kapele dhe syze dielli gjatë procesit mësimor.		
Kreu IX, Neni 35, Gërma dh	Punonjësi arsimor kujdeset për higjienën personale dhe paraqitjen e jashtme.		
Kreu IX, Neni 36, Pika 1	Shkolla, në çdo fillim viti shkollor, ka ngritur komisionin e etikës dhe sjelljes. Drejtori i institucionit ka organizuar procesin për krijimin e komisionit të ri për çdo vit shkollor.		
Kreu IX, Neni 36, Pika 2	KES-i funksionin mbi bazën e rregullore që e ka hartuar ai vetë, të cilën ia ka paraqitur për miratim drejtorit të IA-së.		
Kreu IX, Neni 36, Pika 3	KES-i përbëhet nga mësues, nxënës dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, me të paktën 5 anëtarë.		
Kreu IX, Neni 36, Pika 4	IA-ja me më pak se 24 klasa ka ngritur komisionin me 5 anëtarë, kurse IA-ja me të paktën 24 klasa me 7 anëtarë.		
Kreu IX, Neni 36, Pika 5	Ia-ja ka përcaktuar në rregulloren e brendshme numrin e mësuesve, të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe nxënësve në përbërje të KES-it.		
Kreu IX, Neni 36, Pika 6	Mësuesit në komision janë zgjedhur me shumicë të thjeshtë votash nga këshilli i mësuesve. Prindërit janë zgjedhur nga këshilli i prindërve të IA-së me shumicë të thjeshtë të votave. Nxënësit janë zgjedhur nga qeveria e nxënësve me shumicë të thjeshtë votash.		

Kreu IX, Neni 36, Pika 7	Nxënësit në përbërje të KES-it janë mbi moshën 14 vjeç.		
Kreu IX, Neni 36, Pika 8	Drejtori i IA-së nuk bën pjesë në komision.		
Kreu IX, Neni 37, Pika 1	Anëtarët e KES-it kanë caktuar, në mbledhjen e parë, një kryetar dhe një sekretar.		
Kreu IX, Neni 37, Pika 2	Kryetari i KES-it ka organizuar veprimtarinë e komisionit.		
Kreu IX, Neni 37, Pika 3	Sekretari i KES-it ka ndihmuar në dokumentimin e veprimtarisë së komisionit, përmes mbajtjes dhe zbardhjes së procesverbaleve të mbledhjeve.		
Kreu IX, Neni 37, Pika 4	Rregullorja e KES-it ka të përcaktuara detyrat e tjera specifike për kryetarin, sekretarin dhe anëtarët.		
Kreu IX, Neni 37, Pika 5, Gërma a	Anëtari KES-it është larguar nga komisioni, kur ka dhënë dorëheqjen.		
Kreu IX, Neni 37, Pika 5, Gërma b/i	Anëtari KES-it është larguar nga komisioni, kur shumica e anëtarëve ka vendosur përjashtimin e tij për shkelje të normave të etikës dhe sjelljes që bien në kundërshtim me veprimtarinë e komisionit.		
Kreu IX, Neni 37, Pika 5, Gërma b/ii	Anëtari KES-it është larguar nga komisioni, kur shumica e anëtarëve ka vendosur përjashtimin e tij kur vihet në dyshim integriteti i tij, për shkak të procedimeve administrative civile, penale që vijnë ndaj tij.		
Kreu IX, Neni 37, Pika 5, Gërma b/iii	Anëtari KES-it është larguar nga komisioni, kur shumica e anëtarëve ka vendosur përjashtimin e tij për shkelje të normave të etikës dhe sjelljes që bien në kur ka munguar në tri mbledhje radhazi në mënyrë të pajustificuar.		
Kreu IX, Neni 37, Pika 6	Kur pozicioni i anëtarit ka mbetur i lirë, anëtari i ri është zgjedhur me të njëjtën procedurë siç ishte zgjedhur anëtari i larguar.		
Kreu IX, Neni 38, Pika 1, Gërma a	KES-i, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ka zbatuar kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe është udhëhequr nga parimet e mëposhtme parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit.		
Kreu IX, Neni 38, Pika 1, Gërma b	KES-i, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ka zbatuar kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe është udhëhequr nga parimet e mëposhtme parimi i paanësisë në vendimmarrje.		
Kreu IX, Neni 38, Pika 1, Gërma c	KES-i, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ka zbatuar kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe është udhëhequr nga parimet e mëposhtme parimi i transparencës.		
Kreu IX, Neni 38, Pika 1, Gërma ç	KES-i, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ka zbatuar kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe është udhëhequr nga parimet e mëposhtme parimi i shqyrtimit brenda një afati kohor të arsyeshëm.		
Kreu IX, Neni 38,	KES-i, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ka zbatuar kërkesat		

Pika 1, Gërma d	e legjislacionit në fuqi dhe është udhëhequr nga parimet e mëposhtme parimi i mbrojtjes së të dhënave personale.		
Kreu IX, Neni 38, Pika 2	Anëtarët e KES-it nuk kanë qenë pjesë e shqyrtimit dhe vendimmarrjes, në rastet kur janë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit.		
Kreu IX, Neni 39, Pika 1	KES-i ka trajtuar të gjitha ankesat që i janë paraqitur me shkrim brenda objektit të veprimtarisë së tij. Ankesat që janë paraqitur në KES janë sipas shtojcës nr. 6, të kësaj Rregulloreje.		
Kreu IX, Neni 39, Pika 2	KESI-i, me nismën e tij, ka trajtuar raste të shkeljeve të etikës, të kryera nga punonjësi arsimor, të cilat vijnë në kundërshtim me rregullat e parashikuara në Kodin e Etikës dhe në aktet e tjera në fuqi. Propozimin e tij për masë disiplinore e ka përcjellë te drejtori i IA-së, për t'u trajtuar në komisionin e disiplinës.		
Kreu IX, Neni 39, Pika 3	KES-i ka thirrur palët për t'i ballafaquar (kur e ka parë të nevojshme).		
Kreu IX, Neni 39, Pika 4	KES-i ka shqyrtuar dhe ka gjykuar në bazë të fakteve e provave të administruara në seancën dëgjimore për palën ndaj të cilës është propozuar masa disiplinore. Në rastet kur është vërtetuar se pala ka shkelje të etikës dhe të rregullores së brendshme të IA-së, përveç rasteve kur ato përbëjnë vepër penale, komisioni ka propozuar masa sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.		
Kreu IX, Neni 39, Pika 5	Në rastet kur ankues ka qenë nxënësi, KES-i në procedurën e ballafaqimit, ka pasur të pranishëm psikologun apo punonjësin social.		
Kreu IX, Neni 39, Pika 6	KES-i, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, i ka propozuar drejtorit të IA-së masën disiplinore për çështjet e ngritura në ankesë, në përputhje me parashikimet e rregullores. Vendimmarrja është bërë nga komisioni i disiplinës.		
Kreu IX, Neni 39, Pika 7	KES-i ka njoftuar palët për përfundimin e shqyrtimit të ankesës, sipas të dhënave të përcaktuara në shtojcën nr. 7, të kësaj Rregulloreje.		
Kreu IX, Neni 39, Pika 8, Gërma a	KES-i ka dhënë rekomandime për t'u zbatuar nga punonjësit arsimorë në funksion të standardeve të Kodit të Etikës.		
Kreu IX, Neni 39, Pika 8, Gërma b	KES-i ka siguruar një sistem të vazhdueshëm informimi për rëndësinë e integritetit të punonjësit arsimor.		
Kreu IX, Neni 39, Pika 8, Gërma c	KES-i ka ndjekur nivelin drejtues dhe administruar të IA-së dhe është siguruar që ai është sipas standardeve të Kodit të Etikës.		
Kreu IX, Neni 40, Pika 1	KES-i është mbledhur sa herë që është paraqitur një ankesë dhe/ose me nismën e tij në lidhje me çështje që përfshihen në objektin e veprimtarisë së tij, por jo më pak se 4 herë gjatë një viti mësimor.		

Kreu IX, Neni 40, Pika 2	Mbledhja e KES-it është zhvilluar kur kanë marrë pjesë shumica e thjeshtë e anëtarëve të tij; në rast të kundërt mbledhja është shtyrë.		
Kreu IX, Neni 40, Pika 3	KES-i i ka marrë vendimet me shumicë të thjeshtë votash. Vendimet janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e pranishëm.		
Kreu IX, Neni 41, Pika 1	Drejtori i IA-së ka miratuar rregulloren e KES-it.		
Kreu IX, Neni 41, Pika 2	Drejtori i IA-së i ka kërkuar KES-it këshilla për aspekte të përmirësimit të etikës dhe sjelljes në institucion dhe ka marrë përgjigje me shkrim.		
Kreu IX, Neni 41, Pika 3	Komunikimi mes drejtorit të IA-së dhe KES-i është bërë vetëm me shkrim.		
Kreu IX, Neni 41, Pika 4	Drejtori i IA-së ka siguruar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e takimeve dhe ruajtjen e dokumentacionit të komisionit.		
Kreu IX, Neni 41, Pika 5	KES-i, bazuar në ankesat që i janë paraqitur dhe/ose rastet që ka iniciuar ai, i ka paraqitur me shkrim drejtorit të IA-së përgjithësimet e shkeljeve të normave të etikës dhe të sjelljes në institucion dhe ka propozuar masa që drejtori mund të ndërmarrë për t'i parandaluar ose pakësuar ato.		
Kreu IX, Neni 41, Pika 6	Kryetari i KES-it i ka dërguar propozimet për masat edhe te kryetari i bordit dhe kryetari i këshillit të prindërve.		
Kreu IX, Neni 41, Pika 7	KES-i ka hartuar raportin vjetor të veprimtarisë së tij në përfundim të vitit shkollor dhe ia ka paraqitur drejtorit të IA-së. Drejtori i IA-së ia ka dërguar raportin zyrtarisht ZVA-së.		

**KREU X**  
**DREJTORI I INSTITUCIONIT ARSIMOR**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu X, Neni 42, Pika 1	Drejtori i IA-së, si titullar i institucionit, është i vetmi që ka të drejtën e firmës dhe të vulës së institucionit.		
Kreu X, Neni 42, Pika 2	Drejtori i IA-së, kur ka munguar përkohësisht, i ka deleguar me shkrim njërit prej nëndrejtorëve ose një mësuesi të institucionit, kur nuk ka nëndrejtor, të drejtën e firmës dhe të vulës së institucionit, duke saktësuar kompetencat e deleguara dhe afatin e delegimit, si dhe ka njoftuar ZVA-në për këtë delegim.		
Kreu X, Neni 42, Pika 3	Drejtori i IA-së ka zbatuar kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.		

Kreu X, Neni 42, Pika 4	Drejtori i IA-së ka marrë masat për plotësimin brenda afateve kohore të amzës, indeksit të amzës, regjistrin të veçantë dhe të çdo dokumenti shkollor.		
Kreu X, Neni 42, Pika 5	Drejtori i IA-së ka krijuar një klimë bashkëpunimi dhe respekti reciprok ndërmjet punonjësve arsimorë në IA.		
Kreu X, Neni 42, Pika 6	Drejtori i IA-së ka krijuar mundësi bashkëpunimi të IA-së me institucione publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit, dhe me institucione arsimore analoge. Pas shqyrtimit të këtyre bashkëpunimeve në këshillin e mësuesve, drejtori i IA-së publike ka marrë miratimin për to nga titullari i ZVA-së. Organizatat jopublike apo persona të tjerë juridikë janë lejuar të ushtrojnë veprimtari në ambientet e IA-së, pasi kanë marrë miratimin paraprak në ministri.		
Kreu X, Neni 42, Pika 7	Drejtori i IA-së ka zbatuar marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe institucioneve/palëve të tjera.		
Kreu X, Neni 42, Pika 8	Drejtori i IA-së publike ka marrë masa për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësit e arsimit bazë që i përkasin zonës së shkollës. Drejtori i IA-së publike të arsimit bazë me kohë të plotë, ka bashkëpunuar me NjMF-në, këshillin e prindërve të shkollës dhe këshillat e prindërve të klasave, me qeverinë e nxënësve, me shërbimin psiko-social dhe me bordin e shkollës, për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësit.		
Kreu X, Neni 42, Pika 9	Drejtori i IA-së ka ushtruar çdo detyrë tjetër të parashikuar në këtë Rregullore dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.		
Kreu X, Neni 43, Pika 1	Drejtori i IA-së ka organizuar shpërndarjen e informacionit në dispozicion të qytetarëve, me të dhëna të mjaftueshme për cilësinë e shërbimit arsimor të IA-së.		
Kreu X, Neni 43, Pika 2, Gërma a	Drejtori IA-së, pas këshillimit me këshillin e mësuesve, ka vendosur formimin dhe ndarjen e klasave dhe ka marrë miratimin e ZVA-së për këtë ndarje, bazuar në udhëzimin përkatës të ministrisë.		
Kreu X, Neni 43, Pika 2, Gërma b	Drejtori IA-së, pas këshillimit me këshillin e mësuesve, ka caktuar ngarkesën mësimore të mësuesve dhe ka marrë miratimin e ZVA-së për këtë ndarje.		
Kreu X, Neni 43, Pika 2, Gërma c	Drejtori IA-së, pas këshillimit me këshillin e mësuesve, ka caktuar mësuesit kujdestarë të klasave.		
Kreu X, Neni 43, Pika 2, Gërma ç	Drejtori IA-së, pas këshillimit me këshillin e mësuesve, ka hartuar orarin mësimor javor të institucionit, ose ka ngarkuar një nëndrejtor ose mësues për hartimin e këtij orari.		
Kreu X, Neni 43, Pika	Drejtori i IA-së ka përgatitur çdo muaj listëprezencën e punonjësve të IA-së.		

2, Gërma d			
Kreu X, Neni 43, Pika 3	Drejtori i IA-së ka shpallur në një vend të dukshëm për nxënësit dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre, orarin javor të takimeve, të cilat janë kërkuar nga nxënës ose persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre, si dhe kalendarin e takimeve me ta.		
Kreu X, Neni 44, Pika 1	Drejtori i IA-së ka siguruar zbatimin e dokumenteve kurrikulare, të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin.		
Kreu X, Neni 44, Pika 2	Drejtori IA-së ka organizuar periodikisht analizën e gjendjes reale të rezultateve të nxënësve për çdo periudhë dhe në fund të vitit shkollor.		
Kreu X, Neni 44, Pika 3	Drejtori IA-së ka drejtuar hartimin e planit, që përcakton mënyrat konkrete për përmirësimin e rezultateve të nxënësve me nevoja të veçanta.		
Kreu X, Neni 44, Pika 4, Gërma a	Drejtori i IA-së ka siguruar zhvillimin cilësor të kurrikulës në bazë shkolle.		
Kreu X, Neni 44, Pika 4, Gërma b	Drejtori i IA-së ka përmbushur pëlqimet e nxënësve për lëndët me zgjedhje.		
Kreu X, Neni 44, Pika 5	Drejtori i IA-së, në bashkëpunim me këshillin e mësuesve, ka shqyrtuar rregullisht mbingarkesën e mundshme të nxënësve.		
Kreu X, Neni 44, Pika 6	Drejtori i IA-së ka marrë nisma dhe ka nxitur e ka mbështetur zbatimin e TIK-ut në administrimin e menaxhimin e institucionit dhe në zhvillimin e kurrikulës.		
Kreu X, Neni 44, Pika 7	Drejtori i IA-së ka lejuar të përdoren nga nxënësit në IA vetëm botime ndihmëse dhe materiale të tjera mësimore, të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin, nëpërmjet udhëzimeve të tij.		
Kreu X, Neni 44, Pika 8	IA-ja ka aplikuar në strukturat përkatëse arsimore për pjesëmarrje në kërkimet shkencore dhe eksperimentimet (nëse e ka parë të arsyeshme pjesëmarrjen).		
Kreu X, Neni 44, Pika 9	Drejtori i IA-së nuk ka ngarkuar mësuesit me detyra shtesë, të cilat nuk rrjedhin drejtpërdrejt nga zbatimi i legjislacionit arsimor në fuqi.		
Kreu X, Neni 45, Pika 1	Drejtori i IA-së ka hartuar dhe ka zbatuar planin për zhvillimin e brendshëm profesional të punonjësve të IA-së.		
Kreu X, Neni 45, Pika 2	Drejtori i IA-së ka nxitur dhe ka kontrolluar pjesëmarrjen e mësuesve në rrjetet profesionale.		
Kreu X, Neni 45, Pika 3, Gërma a	Drejtori i IA-së ka organizuar përhapjen e përvojave të mësuesve që kanë marrë pjesë në trajnime.		
Kreu X, Neni 45, Pika 3, Gërma b	Drejtori i IA-së ka organizuar ndihmën profesionale të mësuesve më me përvojë ndaj mësuesve më të rinj.		
Kreu X, Neni 45, Pika	Drejtesit e IA-së kanë vëzhguar orë mësimore, orë të kujdestarisë, mbledhje të ekipeve lëndore, takime të		

4, Gërma a	mësuesve kujdestarë me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe veprimtari jashtëkurrikulare.		
Kreu X, Neni 45, Pika 4, Gërma b	Drejtuesit e IA-së kanë organizuar zhvillimin e pyetësorëve me nxënës, me persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre dhe me mësues.		
Kreu X, Neni 46	Titullari i ZVA-së ka vlerësuar në fund të çdo viti shkollor drejtorin e IA-së, bazuar në standardet e drejtorit të shkollës dhe në performancën e IA-së. Vlerësimi i drejtorit të IA-së është pjesë e dosjes së drejtorit.		
Kreu X, Neni 47, Pika 1	Drejtorja e IA-së ka si anëtarë drejtorin, nëndrejtorët (nëse ka) dhe kryemësuesit e shkollave vartëse (nëse ka).		
Kreu X, Neni 47, Pika 2	Drejtori IA-së ka përcaktuar me shkrim kompetencat dhe detyrat përkatëse për nëndrejtor-in/ët, duke i ngarkuar me detyra të caktuara.		
Kreu X, Neni 47, Pika 3	Nëndrejtori i ka raportuar drejtorit të IA-së për realizimin e detyrave, sipas përshkrimit të punës, bazuar në standardet e miratuara në fuqi.		
Kreu X, Neni 47, Pika 4	Drejtori ka ngarkuar mësuesit me detyra të posaçme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shkollës.		
Kreu X, Neni 47, Pika 5	Drejtorja e IA-së ka ftuar në takimet e organizuara një herë në tre muaj: a) bordin e institucionit; b) këshillin e prindërve të institucionit; c) qeverinë e nxënësve. Për këto takime është mbajtur procesverbal, i cili është nënshkruar nga drejtori. Drejtorja e IA-së ka zhvilluar parateste me nxënësit e klasave të pesta, të nënta dhe me maturantët. Notat e paratesteve nuk janë përfshirë në vlerësimin vjetor të nxënësve.		
Kreu X, Neni 47, Pika 6	Drejtorja e IA-së ka kryer teste me short.		
Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma a	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion ka sistemuar dhe ka mirëmbajtur arkivin e institucionit.		
Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma b	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion ka plotësuar me përgjegjësi: amzën, indeksin e saj dhe regjistrin e veçantë, në përputhje me udhëzimet që jepen në faqen e parë të tyre.		
Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma c	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion ka përgatitur dokumentet e lëshuara nga shkolla për nxënësit ose ish-nxënësit e saj.		
Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma ç	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion ka njoftuar drejtorinë e IA-së për gabimet gjatë plotësimit të dokumentacionit. Ndrejta e gabimeve është bërë vetëm në praninë e drejtorit dhe të dy mësuesve, duke nënshkruar të gjithë një procesverbal ku shpjegohet korrigjimi.		

Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma d	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion ka marrë dhe ka dërguar postën zyrtare.		
Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma dh	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion ka përgatitur dhe ka ruajtur, sipas kuadrit ligjor në fuqi, statistikën që dërgohen në ZVA.		
Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma e	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion, për çdo regjistrim të ri të nxënësve ka siguruar dhe ka ruajtur dokumentacionin e kërkuar sipas akteve nënligjore në fuqi.		
Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma ë	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion ka përgatitur procedurat e transferimit të nxënësve.		
Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma f	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion ka administruar regjistrat e klasave në përdorim të përditshëm.		
Kreu X, Neni 48, Pika 1, Gërma g	Sekretari i IA-së/personi i caktuar me këtë funksion ka kryer çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga drejtori i IA-së.		

**KREU XI  
PLANET E INSTITUCIONIT ARSIMOR  
VLERËSIMI I BRENDSHËM,  
RAPORTI VJETOR**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu XI, Neni 49, Pika 1	Plani afatmesëm i IA-së është hartuar për katër vite shkollore.		
Kreu XI, Neni 49, Pika 2	Drejtori i IA-së, në fillim të vitit shkollor, ka ngritur grupin qendror të punës për hartimin e planit afatmesëm, të përbërë nga: mësues, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe nxënës, të kryesuar prej tij. Në kopsht ky grup pune është i përbërë nga mësues dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve.		
Kreu XI, Neni 49, Pika 3, Gërma a	Grupi qendror ka hartuar draftin e planit afatmesëm në bashkëpunim me grupet e punës të ngritura prej tij.		
Kreu XI, Neni 49, Pika 3, Gërma b	Grupi qendror ka organizuar diskutimin e draftit me këshillin e mësuesve, këshillin e prindërve, bordin e institucionit, qeverinë e nxënësve dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit shkollor.		
Kreu XI, Neni 49, Pika 4	Drejtori i IA-së i ka paraqitur bordit të institucionit për miratim planin afatmesëm, brenda datës 15 prill të vitit shkollor. Plani afatmesëm është nënshkruar nga drejtori dhe kryetari i bordit.		
Kreu XI, Neni 49, Pika 5	Drejtori i IA-së i ka paraqitur për miratim titullarit të ZVA-së draftin e planit afatmesëm, brenda datës 30 prill të atij		



	viti shkollor.		
Kreu XI, Neni 49, Pika 6	Titullari i ZVA-së ka miratuar planin afatmesëm, brenda muajit maj të atij viti shkollor.		
Kreu XI, Neni 49, Pika 7	Drejtori i IA-së ka ngritur një grup të posaçëm pune me tre anëtarë për të vëzhguar zbatimin e planit afatmesëm. Grupi mbikëqyrës i ka raportuar me shkrim çdo 6 muaj drejtorit, lidhur me ecurinë e zbatimit të planit afatmesëm.		
Kreu XI, Neni 49, Pika 8	Drejtori i IA-së i ka raportuar një herë në vit bordit, për zbatimin e planit afatmesëm.		
Kreu XI, Neni 49, Pika 9	Ndryshimet në planin afatmesëm (nëse kanë qenë të domosdoshme të bëhen) janë miratuar nga bordi dhe titullari i ZVA-së.		
Kreu XI, Neni 50, Pika 1	Plani afatmesëm i IA-së është mbështetur në planin afatmesëm të ZVA-së dhe në strategjinë kombëtare për arsimin.		
Kreu XI, Neni 50, Pika 2	Plani afatmesëm i IA-së është i përbërë nga këto rubrika: misioni, vizioni, analiza e gjendjes, përparësitë, veprimtaritë kryesore për realizimin e përparësive, produkti ose treguesit e arritjeve, buxheti i përafërt.		
Kreu XI, Neni 50, Pika 3	Misioni përmbledh detyrimin ose përgjegjësitë kryesore që ka IA-ja gjatë katër viteve.		
Kreu XI, Neni 50, Pika 4	Vizioni përmbledh aspiratën e komunitetit dhe të punonjësve arsimorë për cilësinë e shërbimit arsimor të ofruar nga IA-ja.		
Kreu XI, Neni 50, Pika 5, Gërma a	Analiza e gjendjes përmban tregues për numrin e nxënësve, të mësuesve dhe të klasave para zbatimit të planit afatmesëm.		
Kreu XI, Neni 50, Pika 5, Gërma b	Analiza e gjendjes përmban tregues disa anë të forta dhe të dobëta si: ndjekja e institucionit arsimor nga nxënësit, aspekti social i nxënësve dhe i komunitetit të IA-së, rezultatet e nxënësve, sjellja e nxënësve, niveli profesional i mësuesve dhe të tjera që vlerësohen të rëndësishme për IA-në.		
Kreu XI, Neni 50, Pika 6	Plani afatmesëm përmban deri në tri përparësi, të cilat përcaktojnë drejtimit kryesore të përmirësimeve të IA-së, gjatë katër viteve. Përparësitë e planit afatmesëm janë të njohura nga mësuesit, nxënësit dhe personat që ushtrojnë përgjegjësitë prindërore, si dhe janë të shpallura në një mjedis të dukshëm të shkollës.		
Kreu XI, Neni 50, Pika 7	Veprimtaritë përshkruajnë mënyrën e realizimit të çdo përparësie dhe janë me objektiva të matshëm dhe me afate të përcaktuara.		
Kreu XI, Neni 50, Pika 8	Produkti ose treguesit e arritjeve përshkruajnë procedurën dhe instrumentin që përdoret për të përcaktuar arritjet		

	kryesore (p.sh.: procesverbali i mbledhjeve, materialet e përdorura bashkërisht etj.).		
Kreu XI, Neni 51, Pika 1	Plani vjetor i IA-së është bazuar në planin afatmesëm të institucionit dhe arritjet e vitit shkollor të mëparshëm.		
Kreu XI, Neni 51, Pika 2	Plani vjetor është hartuar dhe është zbatuar nga grupe pune, të përbërë nga: mësues, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve, nga këshillat e prindërve, nxënës nga qeveria e nxënësve (vetëm për shkollën) dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti.		
Kreu XI, Neni 51, Pika 3	Plani vjetor është i përbërë nga këto rubrika: procedura e hartimit të planit, analiza e gjendjes, synimi, objektivi (objektivat), veprimtaritë për realizimin e objektivit (objektivave), veprimtaritë për vëzhgimin e zbatimit të planit vjetor, buxheti (nëse ka nevojë për buxhet).		
Kreu XI, Neni 52, Pika 1	Analiza e gjendjes për vitin e kaluar mësimor përmban si tregues: <i>Ndjekja e IA-së</i> (përqindja e braktisjes së shkollës, përqindja e mungesave vjetore të gjithë nxënësve kundrejt të gjitha orëve mësimore).		
Kreu XI, Neni 52, Pika 2	Analiza e gjendjes për vitin e kaluar mësimor përmban si tregues: <i>Aspekti social</i> : numri i nxënës/fëmijëve nga familje me ndihmë ekonomike; i nxënësve/fëmijëve pa një prind, që nuk janë nën kujdestarinë e prindërve; i nxënësve/fëmijëve të sapoardhur nga krahina të tjera ose nga jashtë vendit; i nxënësve/fëmijëve me aftësi të kufizuara; i fëmijëve romë dhe egjiptianë; të rikthyer nga emigracioni, azilantë, emigrantë etj., sipas specifikave të shkollës.		
Kreu XI, Neni 52, Pika 3	Analiza e gjendjes për vitin e kaluar mësimor përmban si tregues: <i>Rezultatet e nxënësve</i> : mesatarja e notës vjetore të shkollës dhe përqindja e kalueshmërisë pas provimeve të sesionit të dytë, diferenca e notës mesatare të klasës së nëntë në lëndët e gjuhës shqipe, të gjuhës së huaj dhe të matematikës në fund të vitit mësimor dhe në provimet kombëtare të arsimit bazë ose diferenca e notës mesatare të shkollës për të gjitha lëndët e përfshira në maturën shtetërore, ndërmjet fundit të vitit mësimor dhe maturës shtetërore (në kopsht shënohen arritjet e fëmijëve në fushat e të nxënësve).		
Kreu XI, Neni 52, Pika 4	Analiza e gjendjes për vitin e kaluar mësimor përmban treguesit për të cilët IA-ja ka arritjen më të lartë dhe më të ulët në renditje për institucionet arsimore të suksesshme në nivel ZVA-je.		
Kreu XI, Neni 52, Pika 5	Analiza e gjendjes për vitin e kaluar mësimor përmban si tregues: <i>Etika dhe sjellja</i> : numri i masave disiplinore ndaj nxënësve, numri i ankesave të nxënësve që konsiderohen të drejta nga komisioni i etikës dhe sjelljes (vetëm për		

	shkollën).		
Kreu XI, Neni 52, Pika 6	Analiza e gjendjes për vitin e kaluar mësimor përmban si tregues: <i>Arritjet</i> në provimet kombëtare dhe në testimet kombëtare e ndërkombëtare.		
Kreu XI, Neni 52, Pika 7	Analiza e gjendjes për vitin e kaluar mësimor përmban si tregues: <i>Mësuesit</i> : përqindja e orëve mësimore të munguara nga mësuesit kundrejt të gjitha orëve mësimore, numri i krediteve të punonjësve arsimorë.		
Kreu XI, Neni 52, Pika 8	Analiza e gjendjes për vitin e kaluar mësimor përmban si tregues: <i>Pjesëmarrja</i> në projekte me OJF, në olimpiada, konkurse, gara.		
Kreu XI, Neni 52, Pika 9	Analiza e gjendjes për vitin e kaluar mësimor përmban si tregues: Qëndrimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga IA-ja (pyetësor me 10%-20% të nxënësve të klasave të shkollës me pyetjen: “Sa të kënaqur jeni nga shkolla?. Përqindja e nxënësve që janë “Shumë të kënaqur”, “Të kënaqur”, “Jo të kënaqur”). Në kopsht, pyetësorët janë zhvilluar me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve.		
Kreu XI, Neni 52, Pika 10	IA-ja ka shtuar tregues të tjerë për rubrika të caktuara.		
Kreu XI, Neni 52, Pika 11	Për secilën rubrikë janë shënuar një deri në dy anë të forta dhe anë të dobëta të IA-së gjatë vitit shkollor të kaluar.		
Kreu XI, Neni 53, Pika 1	Plani vjetor ka një synim që përshkruan një përparësi të IA-së gjatë një viti shkollor.		
Kreu XI, Neni 53, Pika 2	Objektivi (objektivat) tregon nivelin e arritjes së synimit gjatë vitit shkollor. Çdo objektivi lidhet me rezultatet e nxënësve, është i matshëm, mundëson krahasimin e IA-së gjatë viteve dhe nuk nxit ngritjen fiktive të notave. Objektivi është shpallur në mjediset e institucionit arsimor.		
Kreu XI, Neni 53, Pika 3	Në planin vjetor janë shënuar afatet dhe personat përgjegjës për realizimin e objektivit (objektivave), si dhe ata që vëzhgojnë zbatimin e planit vjetor.		
Kreu XI, Neni 53, Pika 4	Drejtoria, në bashkëpunim me grupet e punës, kanë vëzhguar rregullisht realizimin e veprimtarive të parashikuara dhe kanë vlerësuar ecurinë e arritjes.		
Kreu XI, Neni 53, Pika 5	Buxheti për një plan vjetor (nëse është i nevojshëm) përmban burimet e financimit dhe shpenzimet sipas veprimtarive.		
Kreu XI, Neni 53, Pika 6	Drejtori i ka paraqitur për miratim plani vjetor bordit të IA-së. Plani vjetor, i nënshkruar nga drejtori dhe kryetari i bordit të IA-së, i është paraqitur për miratim te titullari i ZVA-së.		
Kreu XI, Neni 53, Pika 7	Plani vjetor është gati për t’u zbatuar që ditën e parë të		

	fillimit të vitit shkollor.		
Kreu XI, Neni 54, Pika 1	Institucioni arsimor ka kryer vlerësimin e brendshëm, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga ana e tij, nëpërmjet analizës dhe reflektimit për arritjet dhe mundësitë për përmirësime.		
Kreu XI, Neni 54, Pika 2	Vlerësimi i brendshëm ka analizuar anët e forta, mundësitë për përmirësime, faktorët që kanë favorizuar ose penguar cilësinë.		
Kreu XI, Neni 54, Pika 3, Gërma a	Vlerësimi i brendshëm ka përfshirë të gjithë punonjësit arsimorë të institucionit, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin.		
Kreu XI, Neni 54, Pika 3, Gërma b	Vlerësimi i brendshëm është kryer çdo vit.		
Kreu XI, Neni 54, Pika 3, Gërma c	Vlerësimi i brendshëm ka mbuluar të gjitha fushat që mbulon monitorimi dhe vlerësimi i IA-së.		
Kreu XI, Neni 54, Pika 4	Vlerësimi i brendshëm është kryer në nivel individual (drejtori, nëndrejtori, mësuesi) dhe në nivel organizmash të IA-së (drejtoria, këshilli i mësuesve, ekipi lëndor).		
Kreu XI, Neni 54, Pika 5	Secili drejtues, mësues, organizëm kryesor i shkollës ka kryer vetëvlerësimin e tij, duke përdorur metoda dhe instrumente të përzgjedhura nga këshilli i mësuesve.		
Kreu XI, Neni 54, Pika 6	Vlerësimi i brendshëm është realizuar nga një grup qendror, i përbërë nga anëtarët e drejtorisë së shkollës dhe kryetarët e ekipeve lëndore. Drejtori i institucionit, në planifikim dhe gjatë procesit të vetëvlerësimit, ka qenë vetëm koordinator, mbështetës dhe monitorues, që ka ndjekur hap pas hapi gjithë procesin, pa ndërhyrë asnjëherë me autoritetin e tij zyrtar, që mund të ndikojë në rezultat.		
Kreu XI, Neni 54, Pika 7	Etapat e vlerësimit të brendshëm janë zhvilluar sipas udhëzuesit metodologjik për vlerësimin e brendshëm.		
Kreu XI, Neni 55, Pika 1	Drejtori i IA-së, në fund të vitit shkollor, i ka dërguar titullarit të ZVA-së raportin vjetor të institucionit.		
Kreu XI, Neni 55, Pika 2	Raporti vjetor është bazuar në planin vjetor të IA-së.		
Kreu XI, Neni 55, Pika 3	Raporti vjetor ka përshkruar: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) përmbushjen e objektivave të planit vjetor dhe shkaqet e mospërmbushjes (nëse ka);</li> <li>b) aspektet financiare (për shkollat publike);</li> <li>c) risi të suksesshme në drejtimin e institucionit dhe në procesin mësimor, të realizuara gjatë vitit shkollor;</li> <li>ç) bashkëpunimet e suksesshme të institucionit me OJF etj.;</li> <li>d) certifikata, çmime etj., të fituara nga institucioni, nga nxënës dhe punonjës të tij;</li> </ul>		

	dh) propozime për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në IA, në nivel vendor dhe kombëtar.		
Kreu XI, Neni 55, Pika 4	Raporti vjetor është hartuar nën drejtimin e drejtorit të IA-së, nga një grup pune i përbërë nga mësues, përfaqësues të këshillit të prindërve dhe qeveria e nxënësve. Raporti vjetor është dërguar në ZVA, pas shqyrtimit nga këshilli i mësuesve, bordi dhe këshilli i prindërve të institucionit.		
Kreu XI, Neni 55, Pika 5	Raporti vjetor është publikuar në faqen e internetit të IA-së.		

## KREU XII MËSUESI DHE PUNONJËSI ARSIMOR

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu XII, Neni 56, Pika 1, Gërma a	Mësuesit i është garantuar e drejta të kryejë punën në kushte të sigurta për jetën dhe shëndetin e tij.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 1, Gërma b	Mësuesi trajtohet me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme nga kushdo, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminim.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 1, Gërma c	Mësuesit i janë siguruar kushtet e mjaftueshme për mësimdhënie efektive.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 1, Gërma ç	Drejtori i IA-së ka informuar në kohë mësuesin për dokumentet zyrtare që kanë lidhje me veprimtarinë e tij.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 1, Gërma d	Mësuesit i është dhënë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, liri profesionale në zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 1, Gërma dh	Mësuesit i janë krijuar mundësitë për zhvillim profesional.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 1, Gërma e	Mësuesit i është dhënë e drejta të marrë pjesë në veprimtari shkencore vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 2, Gërma a	Mësuesi ka përmbushur detyrimet që lidhen me ushtrimin e profesionit të tij.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 2, Gërma b	Mësuesi ka zbatuar Kodin e Etikës së mësuesit.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 2, Gërma c	Mësuesi trajton këdo, në mjediset e IA-së, me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminim, pa dhunë.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 2, Gërma ç	Mësuesi është përkujdesur për mbarëvajtjen e çdo nxënësi.		

Kreu XII, Neni 56, Pika 2, Gërma d	Mësuesi ka dhënë ndihmesën e tij për mbarëvajtjen e institucionit ku punon.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 2, Gërma dh	Mësuesi ka kërkuar të shqyrtohen në drejtorinë e IA-së, këshillin e mësuesve, këshillin e prindërve dhe bordin e institucionit, çështje që kanë shqetësuar cilësinë e shërbimit arsimor në institucion.		
Kreu XII, Neni 56, Pika 2, Gërma e	Mësuesi ka kryer me përgjegjësi detyrat që i janë ngarkuar në provimet kombëtare dhe në testimin ndërkombëtar.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 1	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari kanë respektuar Kodin e Etikës së Mësuesit.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 2, Gërma a	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk kanë ushtruar dhunë fizike ose psikologjike ndaj nxënësve ose kolegëve.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 2, Gërma b	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk kanë larguar nxënësin nga klasa dhe shkolla për çështje a nevoja vetjake të tij.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 2, Gërma c	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk bëjnë kurse private me nxënësit e shkollës së tyre.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 2, Gërma ç	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk pijnë duhan ose pije alkoolike në institucionin arsimor.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 2, Gërma d	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk kanë pasur marrëdhënie me para me nxënësit ose personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 2, Gërma dh	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk kanë detyruar nxënësit të blejnë literaturë që nuk përfshihet në katalogun e teksteve shkollore.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 2, Gërma e	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk u kanë deklaruar nxënësve bindjet të tyre partiake ose fetare.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 2, Gërma ë	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk kanë detyruar nxënësit ose mësuesit të marrin pjesë në veprimtari partiake ose fetare.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 2, Gërma f	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk kanë përdorur celularin gjatë procesit mësimor.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 3	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari nuk kanë marrë pjesë në grupe pune që kanë me të konflikt interesi.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 4 Gërma a	IA-ja publike/private ka ndaluar propagandimin dhe organizimin e veprimtarive partiake.		

Kreu XII, Neni 57, Pika 4, Gërma b	IA-ja publike/private ka ndaluar propagandimin dhe organizimin e veprimtarive fetare, përveç në institucionet e parashikuara në pikën 4, të nenit 42, të LAPU-t.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 5	Ndalimet e tjera për punonjësin arsimor, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin janë përshkruar në rregulloren e brendshme të IA-së, në përputhje me Kodin e Punës, Kodin e Etikës, Kontratën Kolektive dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 6	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari i IA-së mbajnë uniformë gjatë qëndrimit në mjediset e institucionit. Uniforma për punonjësit arsimorë është përcaktuar nga këshilli i mësuesve.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 7	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari kanë njoftuar paraprakisht titullarin e tyre për mungesat në punë.		
Kreu XII, Neni 57, Pika 8	Mungesat e punonjësve arsimorë të institucionit, përfshirë drejtuesit, janë trajtuar në përputhje me Kodin e Punës.		
Kreu XII, Neni 58, Pika 1	Punonjësit arsimor, psikologut, punonjësit social, oficerit të sigurisë dhe sekretarit u është dhënë e drejta të ankohen: a) për qëndrimet dhe vendimet ndaj tij; b) për qëndrimet dhe vendimet ndaj një punonjësi tjetër ose ndaj një nxënësi.		
Kreu XII, Neni 58, Pika 2	Ankimi është paraqitur me shkrim brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kreu XII, Neni 58, Pika 3	Ankimi ka nisur nga niveli më i ulët institucional dhe ka vazhduar i përshkallëzuar, duke kaluar në nivelet më të larta.		
Kreu XII, Neni 58, Pika 4	Përgjegjjet për ankimet janë dhënë me shkrim.		
Kreu XII, Neni 58, Pika 5	Ankimi në nivelin pasardhës është shoqëruar me kopjen e përgjegjjes së nivelit paraardhës.		
Kreu XII, Neni 58, Pika 6	Në komisionin e ankimeve nuk ka marrë pjesë anëtari në konflikt interesi me ankuesin.		
Kreu XII, Neni 59, Pika 1	Drejtuesit dhe mësuesit e IA-së publike janë paraqitur në shkollë 15 minuta para fillimit të orarit mësimor të IA-së.		
Kreu XII, Neni 59, Pika 2	Drejtuesit dhe mësuesit e IA-së publike qëndrojnë 30 orë në javë në mjediset e shkollës ose në mjedise të tjera për të kryer veprimtaritë e planifikuara mësimore dhe jomësimore, përfshirë veprimtaritë jashtëshkollore, mbledhjet profesionale, takimet me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve, plotësime të dokumentacionit dhe pjesëmarrjen në grupet e punës.		
Kreu XII, Neni 59, Pika 3	Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari janë paraqitur në punë me vonesë ose janë larguar gjatë kohës së punës, vetëm për arsye të veçanta, pasi kanë njoftuar menjëherë drejtorin e IA-së.		

Kreu XII, Neni 59, Pika 4	Punonjësi arsimor është larguar gjatë ditëve të mësimimit për veprimtari shkencore, artistike, kulturore apo sportive vendore, kombëtare e ndërkombëtare, pasi ka marrë paraprakisht miratimin e drejtorit të IA-së. Drejtori i IA-së ka njoftuar titullarin e ZVA-së dhe ka marrë masa për të bërë zëvendësimin.		
Kreu XII, Neni 60, Pika 1	Mësuesi, pesë ditë-pune para fillimit të vitit shkollor, ka dorëzuar te drejtori i IA-së planin lëndor dhe planin lëndor të periudhës së parë.		
Kreu XII, Neni 60, Pika 2	Mësuesi ka hartuar planin lëndor sipas Kornizës Kurrikulare, programit përkatës lëndor ose fushës së të nxënës, pikëpamjeve të tij pedagogjike dhe në përshtatje me nxënësit e tij.		
Kreu XII, Neni 60, Pika 3	Mësuesi, kur janë krijuar rrethana të reja, ka bërë gjatë vitit mësimor ndryshime në planin lëndor. Çdo ndryshim është miratuar nga drejtori i shkollës dhe është pasqyruar në planin e dorëzuar te drejtori.		
Kreu XII, Neni 60, Pika 4	Plani lëndor i mësuesit ka marrë formën përfundimtare pas shqyrtimit të tij nga ekipi lëndor përkatës.		
Kreu XII, Neni 61, Pika 1	Mësuesi ka hartuar rregullisht planin ditor (ditarin) për çdo orë mësimi. Mësuesi ka planifikuar situata të nxënës, në të cilat nxënësit ndërveprojnë për zhvillimin e kompetencave kyç dhe të kompetencave të fushës.		
Kreu XII, Neni 61, Pika 2	Ditari përmban rubrika në përputhje me udhëzuesit kurrikularë.		
Kreu XII, Neni 61, Pika 3	Për klasat paralele ditari përmban (ose jo) vetëm veçoritë e zhvillimit në ato klasa, nëse ka të tilla.		
Kreu XII, Neni 61, Pika 5	Mësuesi e ruan ditarin për një vit shkollor.		
Kreu XII, Neni 62, Pika 1	Drejtori i IA-së ka vlerësuar mësuesin duke u bazuar në standardet profesionale të mësuesit, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.		
Kreu XII, Neni 62, Pika 3	Vlerësimi i mësuesit është mbështetur në kriteret e përcaktuara nga ASCAP-i.		
Kreu XII, Neni 62, Pika 4	Drejtori/nëndrejtori i IA-së, në fund të vitit mësimor, ka vlerësuar mësuesin dhe e ka vënë në dijeni për vlerësimin që i është bërë. Një kopje e vlerësimit, e nënshkruar edhe nga mësuesi, është vendosur në dosjen personale, e cila administrohet në arkivin e IA-së.		
Kreu XII, Neni 63, Pika 1	Mësuesi ka përditësuar portofolin e tij profesional, me dokumente të tilla, si: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) jetëshkrimi i mësuesit (CV);</li> <li>b) certifikata të krediteve të fituara;</li> <li>c) kumtesa që ka mbajtur, duke filluar nga ato në këshillin e mësuesve;</li> </ul>		



	ç ) çmime e certifikata të tjera për merita profesionale; d) vlerësimi vjetor i mësuesit nga drejtori i IA-së; dh) të tjera, sipas dëshirës së mësuesit.		
Kreu XII, Neni 63, Pika 2	Drejtori/nëndrejtori i IA-së ka mbajtur për çdo mësues kopjet e dokumenteve të shkronjave “a”, “b” dhe “dh”, të pikës 1 të këtij neni.		
Kreu XII, Neni 64, Pika 1, Gërma a	Këshilli i mësuesve ka zbatuar aktet e legjislacionit arsimor në fuqi.		
Kreu XII, Neni 64, Pika 1, Gërma b	Këshilli i mësuesve ka dhënë këshilla për përmirësime në drejtimin institucionit arsimor.		
Kreu XII, Neni 64, Pika 1, Gërma c	Këshilli i mësuesve ka analizuar periodikisht rezultatet e nxënësve.		
Kreu XII, Neni 64, Pika 1, Gërma ç	Këshilli i mësuesve ka këshilluar përmirësime në veprimtarinë e IA-së për rezultate më të mira të nxënësve.		
Kreu XII, Neni 64, Pika 1, Gërma d	Këshilli i mësuesve ka shqyrtuar rregullisht përvojat e suksesshme të mësuesve të institucionit dhe ka sugjeruar përhapjen e tyre në institucion.		
Kreu XII, Neni 64, Pika 1, Gërma dh	Këshilli i mësuesve ka shqyrtuar praktikatat e suksesshme të kolegëve të IA-ve vendase dhe ka sugjeruar mënyrat e zbatimit të tyre.		
Kreu XII, Neni 64, Pika 1, Gërma e	Këshilli i mësuesve ka kryer studime për praktikatat e suksesshme të institucioneve analoge të huaja dhe ka sugjeruar mënyrat e zbatimit të tyre.		
Kreu XII, Neni 64, Pika 2	Këshilli i mësuesve është mbledhur, si rregull, jo më pak se një herë në dy muaj. Këshilli i mësuesve është mbledhur edhe në rastin kur e ka gjykuar të arsyeshme drejtori i IA-së apo kur e ka kërkuar jo më pak se 1/3 e anëtarëve të tij. Këshilli i mësuesve ka zhvilluar mbledhjen e parë të paktën 10 (dhjetë) ditë-punë para fillimit të vitit shkollor, në të cilën i ka dhënë mendime drejtorit për: <ul style="list-style-type: none"> <li>- formimin e klasave;</li> <li>- orarin mësimor;</li> <li>- tematikat e përafërta të mbledhjeve të zakonshme të këshillit;</li> <li>- veprimtaritë e zhvillimit të brendshëm profesional;</li> <li>- çështje të tjera, sipas kërkesës së drejtorit ose me nismën e këshillit.</li> </ul>		
Kreu XII, Neni 64, Pika 3	Në përfundim të vitit mësimor, Këshilli i mësuesve ka analizuar veprimtarinë vjetore të IA-së dhe ka rekomanduar synimin dhe objektivat e planit për vitin e ardhshëm.		
Kreu XII, Neni 64, Pika 4	Në mbledhjen e këshillit të mësuesve, drejtori ka ftuar: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) përfaqësues të NJVV-së dhe të ZVA-së;</li> <li>b) punonjës të psiko-social;</li> <li>c) kryetarin e bordit;</li> </ul>		

	<p>ç ) kryetarin e këshillit të prindërve;</p> <p>d) kryetarin e qeverisë së nxënësve;</p> <p>dh) kryetarin e komisionit të etikës dhe sjelljes;</p> <p>e) personelin mjekësor të shkollës (kur ka të tillë);</p> <p>ë) përfaqësues të tjerë nga komuniteti.</p>		
Kreu XII, Neni 64, Pika 5	<p>Drejtori i IA-së ka caktuar një mësues si sekretar të këshillit.</p> <p>Sekretari ka mbajtur shënimet e mbledhjeve në librin e procesverbaleve të këshillit të mësuesve dhe ka vendosur në arkivin e institucionit materialet e paraqitura në këshill nga drejtuesit e institucionit dhe mësuesit.</p> <p>Materialet e paraqitura në këshill nga drejtuesit e institucionit dhe mësuesit janë ruajtur për tri vite shkollore.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 1	<p>Ekipi lëndor është i përbërë nga mësues të shkollës, të cilët japin mësim në po atë lëndë a fushë të nxëni, ose në më shumë se një fushë të nxëni.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 2	<p>Drejtori i shkollës, pas këshillimit me këshillin e mësuesve, ka ngritur ekipet lëndore.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 3	<p>Ekipi lëndor është mbledhur një herë në muaj.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 4, Gërma a	<p>Ekipi lëndor në mbledhjet e tij ka diskutuar për aspekte të praktikave të përditshme profesionale të mësuesve.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 4, Gërma b	<p>Ekipi lëndor në mbledhjet e tij ka trajtuar çështje të integritimit ndërlëndor.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 4, Gërma c	<p>Ekipi lëndor në mbledhjet e tij ka shqyrtuar përvoja të suksesshme të kolegëve dhe praktika vendase dhe të huaja.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 4, Gërma ç	<p>Ekipi lëndor në mbledhjet e tij ka shtjelluar çështje/probleme që i ka çmuar të dobishme për zhvillimin profesional të mësuesve.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 4, Gërma d	<p>Ekipi lëndor në mbledhjet e tij ka shqyrtuar planet lëndore vjetore dhe të periudhës të mësuesve, para dorëzimit të tyre në drejtorinë e IA-së.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 5	<p>Ekipi lëndor ka ftuar në mbledhjet e tij mësues të tjerë të asaj shkolle ose të shkollave të tjera dhe specialistë të kurrikulës.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 6	<p>Ekipi lëndor ka zhvilluar veprimtarinë e tij pa marrë vendime.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 7, Gërma a	<p>Kryetari i ekipit lëndor ka punuar të paktën 5 vjet si mësues në po atë nivel arsimor.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 7, Gërma b	<p>Kryetari i ekipit lëndor është vlerësuar me të paktën “Shumë mirë” në provimin e kualifikimit, nëse e ka dhënë këtë provim.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 7, Gërma c	<p>Kryetari i ekipit lëndor është shquar për rezultatet e nxënësve të tij.</p>		
Kreu XII, Neni 65, Pika 8	<p>Kryetari i ekipit lëndor është propozuar nga anëtarët e</p>		

	ekipit përkatës dhe është caktuar nga drejtori i IA-së.		
Kreu XII, Neni 65, Pika 9	Kryetari i ekipit lëndor ka përgatitur dhe zhvilluar mbledhjet e ekipit.		
Kreu XII, Neni 65, Pika 10	Kryetari i ekipit lëndor ka ruajtur për një vit shkollor procesverbalet e mbledhjeve të ekipit lëndor.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 1	Mësuesi kujdestar i një klase të arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë është caktuar një nga mësuesit lëndorë të klasës. Mësuesi i fillores është caktuar mësuesi kujdestar i klasës së tij.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 2	Drejtori i shkollës ka caktuar mësuesit kujdestarë 15 ditë para fillimit të vitit shkollor.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 3, Gërma a	Mësuesi kujdestar është përkujdesur për krijimin e atmosferës së mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit në mes nxënësve.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 3, Gërma b	Mësuesi kujdestar është përkujdesur për nxënësit me aftësi të veçanta (me aftësi të kufizuara, me vështirësi në të nxënë, të talentuar).		
Kreu XII, Neni 66, Pika 3, Gërma c	Mësuesi kujdestar është përkujdesur për nxënësit e sapoardhur dhe ata me shqetësime të sjelljes.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 3, Gërma ç	Mësuesi kujdestar është përkujdesur për ndjekjen e shkollës nga të gjithë nxënësit.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 3, Gërma d	Mësuesi kujdestar është përkujdesur për plotësimin e pëlqimeve të nxënësve për kurrikulën me zgjedhje.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 3, Gërma dh	Mësuesi kujdestar është përkujdesur për shmangien e mbingarkesës së nxënësit me mësim.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 3, Gërma e	Mësuesi kujdestar është përkujdesur për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet kurrikulare dhe zgjedhjet e karrierës.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 3, Gërma ë	Mësuesi kujdestar ka bashkëpunuar me psikologun/punonjësin social.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 3, Gërma f	Mësuesi kujdestar ka plotësuar faqet e regjistrit.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 4, Gërma a	Orët e kujdestarisë janë përdorur për veprimtari me klasën.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 4, Gërma b	Orët e kujdestarisë janë përdorur për plotësimin e dokumentacionit.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 4, Gërma c	Orët e kujdestarisë janë përdorur për takime e komunikim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 5	Orët e kujdestarisë nuk janë shënuar në orarin e mësimëve të klasës/shkollës.		
Kreu XII, Neni 66, Pika 6	Mësuesi kujdestar, në bashkëpunim me këshillin e prindërve të klasës, ka hartuar planin vjetor të punës, i cili		

	<p>është miratuar nga drejtori i IA-së.</p> <p>Në këtë plan janë përfshirë dhe takimet me të gjithë personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve të klasës.</p>		
Kreu XII, Neni 66, Pika 7	Mësuesi kujdestar ka pasqyruar në regjistrin e klasës takimet e planifikuara dhe të organizuara me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve, si dhe tematikat e tyre.		
Kreu XII, Neni 67, Pika 1	<p>Mësuesi kujdestar ka njohur personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe nxënësit me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) kushtet e shëndetit dhe të sigurisë në IA;</li> <li>b) të drejtat dhe detyrimet e tyre, të pasqyruara në Rregulloren e IA-ve;</li> <li>c) detyrimet e punonjësve të IA-së ndaj tyre;</li> <li>ç) rregulloren e brendshme të institucionit;</li> <li>d) kurrikulën me zgjedhje;</li> <li>dh) mundësitë e karrierës së fëmijës pas përfundimit të një niveli arsimor;</li> <li>e) procedurat e zhdëmtimeve;</li> <li>ë) procedurat e ankimit.</li> </ul>		
Kreu XII, Neni 67, Pika 2, Gërma a	Mësuesi kujdestar ka informuar rregullisht personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore rreth mbarëvajtjes së fëmijës së tyre.		
Kreu XII, Neni 67, Pika 2, Gërma b	Mësuesi kujdestar ka takuar me përparësi personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve me vështirësi në të nxënë, me sjellje shqetësuese dhe ata me probleme në ndjekjen e shkollës.		
Kreu XII, Neni 67, Pika 2, Gërma c	Mësuesi kujdestar është përpjekur të shtojë interesimin e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për mbarëvajtjen e fëmijëve të tyre.		
Kreu XII, Neni 67, Pika 3	Mësuesi kujdestar ka përgatitur për çdo nxënës notat lëndore të çdo periudhe dhe dëftesën e klasës (të arsimit bazë), të cilën ia ka dorëzuar personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit.		
Kreu XII, Neni 67, Pika 4, Gërma a	Mësuesi kujdestar ka ftuar në mbledhje të përgjithshme të gjithë personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, bashkë me nxënësit ose pa ata, të paktën një herë në tre muaj, ku ka parashtruar çështje që i takojnë klasës në tërësi.		
Kreu XII, Neni 67, Pika 4, Gërma b	Mësuesi kujdestar ka ftuar në mbledhje të përgjithshme të gjithë personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, bashkë me nxënësit ose pa ata, të paktën një herë në tre muaj, ku ka shtjelluar tema rreth rolit të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në suksesin e fëmijëve të tyre.		
Kreu XII, Neni 67, Pika 5	Mësuesi kujdestar, në mbledhjet e zhvilluara me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve, nuk ka		

	përmendur me emër nxënës të klasës për mosarritje ose arritje të tyre. Informacioni për nxënësin i është dhënë vetëm personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të tij.		
Kreu XII, Neni 68, Pika 1	Punonjësi arsimor ka lajmëruar menjëherë drejtorinë e IA-së në rastin kur ka konstatuar përdorimin e dhunës verbale, psikologjike, fizike, seksuale nga ana e nxënësit, me anë të shprehjeve dhe/ose veprimeve të ndryshme.		
Kreu XII, Neni 68, Pika 2	Drejtoria e IA-së ka lajmëruar personin që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit për menaxhimin e konfliktit dhe zgjidhjen e situatës.		
Kreu XII, Neni 68, Pika 3	Drejtoria e IA-së, në rastet e dhunës, ka bashkëpunuar me mësuesin kujdestar, psikologun/punonjësin social, oficerin e sigurisë, për trajtimin në vazhdimësi të nxënësit me sjellje të dhunshme në ambientet e IA-së.		
Kreu XII, Neni 68, Pika 4	Drejtori i IA-së ka njoftuar ZVA-në, NjMF-në dhe organet vendore të Policisë së Shtetit, në rastin kur sjellja e dhunshme e shfaqur nga nxënësi përbën vepër penale.		
Kreu XII, Neni 69, Pika 1	Mësuesi nuk ka përdorur dhunë verbale, psikologjike, fizike apo seksuale ndaj nxënësve.		
Kreu XII, Neni 69, Pika 2	Mësuesi kujdestar ose psikologu/punonjësi social i IA-së, në rastin e konstatimit të dhunës ndaj nxënësit, ka njoftuar drejtorin e institucionit.		
Kreu XII, Neni 69, Pika 3	Drejtori i IA-së e ka paraqitur rastin e konstatimit të dhunës ndaj nxënësit para KES-it.		
Kreu XII, Neni 69, Pika 4	Kur KES-i ka konstatuar kryerjen e shkeljeve nga ana e mësuesit, i ka rekomanduar drejtorit të IA-së marrjen e masës disiplinore ndaj mësuesit, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.		
Kreu XII, Neni 69, Pika 5	Drejtori i IA-së, në rastin kur sjellja e dhunshme e shfaqur nga mësuesi përbën vepër penale, ka njoftuar ZVA-në, NjMF-në dhe organet vendore të Policisë së Shtetit për ndjekjen e çështjes.		

### KREU XIII NXËNËSIT

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu XIII, Neni 70, Pika 1	Nxënësit i janë siguruar kushte të qeta dhe të sigurta për jetën dhe shëndetin, në kryerjen e veprimtarisë së tij në IA.		
Kreu XIII, Neni 70, Pika 2	Nxënësi trajtohet me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme në IA, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminim, pa dhunë.		
Kreu XIII, Neni 70, Pika 3	IA-ja ka njohur nxënësin me të drejtat dhe detyrat e tij.		

Kreu XIII, Neni 70, Pika 4	Institucioni arsimor i ka siguruar nxënësit një shërbim arsimor cilësor, sipas interesave, nevojave dhe mundësive të tij, si dhe ndihmë e posaçme për të përballur vështirësitë e tij të veçanta të të nxënësve.		
Kreu XIII, Neni 70, Pika 5	IA-ja ka marrë parasysh kërkesat e nxënësit për kurrikulën me zgjedhje.		
Kreu XIII, Neni 70, Pika 6	IA-ja ka informuar gojarisht dhe me shkrim nxënësin, se ku duhet të drejtohet në rast të shkeljeve të të drejtave të tij.		
Kreu XIII, Neni 71, Pika 1, Gërma a	Nxënësi ka respektuar të drejtat e punonjësve të IA-së dhe nxënësve të tjerë.		
Kreu XIII, Neni 71, Pika 1, Gërma b	Nxënësi ka respektuar rregullat e institucionit për mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë e të mjedisit dhe ka kërkuar respektimin e tyre nga nxënësit e tjerë dhe nga punonjësit arsimorë.		
Kreu XIII, Neni 71, Pika 1, Gërma c	Nxënësi ka mirëmbajtur tekstet shkollore të marra në përdorim falas dhe i ka kthyer ato në gjendje të përdorshme, sipas akteve nënligjore në fuqi.		
Kreu XIII, Neni 71, Pika 1, Gërma ç	Nxënësi ka vijuar rregullisht veprimtarinë mësimore- edukative në IA.		
Kreu XIII, Neni 71, Pika 1, Gërma dh	Nxënësi ka respektuar rregulloren e institucionit.		
Kreu XIII, Neni 71, Pika 2	Nxënësi nuk ka përdorur celularin gjatë orës së mësimi.		
Kreu XIII, Neni 72	Nxënësi vjen në shkollë me një veshje dhe paraqitje serioze që i përgjigjet vendit dhe natyrës së IA-së.		
Kreu XIII, Neni 72, Pika 1	Nxënësi vesh këmbë dhe bluza serioze.		
Kreu XIII, Neni 72, Pika 2	Mëngët e këmbës, të pulovrës/bluzës dhe veshjet e nxënësit në përgjithësi, nuk janë të lirshme dhe të hapura sa të ekspozojnë trupin.		
Kreu XIII, Neni 72, Pika 3	Nxënësi paraqitet në shkollë me veshje jo transparente.		
Kreu XIII, Neni 72, Pika 4	Nxënësi paraqitet në shkollë me pantallona jo të shkurtra.		
Kreu XIII, Neni 72, Pika 5	Nxënësi paraqitet në shkollë pa kapele dhe syze dielli.		
Kreu XIII, Neni 72, Pika 6	Nxënësi kujdeset për higjienën personale dhe paraqitjen e jashtme.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 1	Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë është formuar nga një proces zgjedhor periodik dhe është mbledhur 3 herë në vit.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 2, Gërma a	Anëtari i Parlamentit të Nxënësve ka përfaqësuar nxënësit e shkollave të qytetit të tij.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 2, Gërma b	Anëtari i Parlamentit të Nxënësve ka bashkëpunuar me anëtarët e tjerë.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 2, Gërma c	Anëtari i Parlamentit të Nxënësve ka diskutuar për çështje që shqetësojnë nxënësit e qytetit të tij.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 2, Gërma ç	Anëtari i Parlamentit të Nxënësve ka angazhuar nxënësit e tjerë në aksione komunitare e sociale.		

Kreu XIII, Neni 73, Pika 2, Gërma d	Anëtari i Parlamentit të Nxënësve ka mobilizuar nxënësit dhe të rriturit drejt krijimit të një ndryshimi të qëndrueshëm në komunitet.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 3, Gërma a	Parlamenti i Nxënësve ka organizuar zgjedhjet.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 3, Gërma b	Parlamenti i Nxënësve ka miratuar rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të tij.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 3, Gërma c	Parlamenti i Nxënësve ka marrë pjesë në mbledhjet periodike të iniciuara nga ministria.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 3, Gërma ç	Parlamenti i Nxënësve ka miratuar plane veprimi tre, gjashtë e nëntëmujore.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 3, Gërma d	Parlamenti i Nxënësve ka mirëmbajtur bazën e të dhënave për përfaqësuesit e tij, në nivel qyteti.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 4	Parlamenti i Nxënësve ka 140 anëtarë me të drejtë anëtarësie për 2 vite. Parlamenti i Nxënësve, bazuar në organizimin territorial të bashkive të vendit, ka të përzgjedhur një përfaqësues nga shkollat 9-vjeçare dhe një përfaqësues nga shkollat e mesme, për çdo bashki.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 5	IA-ja, në fillim të vitit shkollor, pas zgjedhjes së qeverive të nxënësve dhe kryetarëve të tyre, ka realizuar zgjedhjet për përfaqësuesit në Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 6	Kryetarët e qeverive të nxënësve për secilën shkollë, sipas nivelit të arsimit parauniversitar, kanë votuar për kandidaturat e përzgjedhura për në Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 7	Qeveria e nxënësve në secilën shkollë ka zgjedhur kandidaturat për Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë, nga kuotat e përcaktuara për: AK, romët, egjiptianët dhe minoritetet.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 8	Kryetarët e qeverive të nxënësve, përveç votimit për njëritjetrin, kanë votuar për kandidaturat e kategorive të veçanta të nxënësve në nivel bashkie.		
Kreu XIII, Neni 73, Pika 9	Parlamenti i Nxënësve funksionon sipas rregullore së brendshme, të hartuar nga anëtarët e përzgjedhur dhe miratuar në ministrinë e Arsimit.		
Kreu XIII, Neni 74, Pika 1, Gërma a	Mësuesi kujdestar, në fund të vitit shkollor, ka shpallur tre nxënësit e klasës me mesataren vjetore më të lartë.		
Kreu XIII, Neni 74, Pika 1, Gërma b	Drejtori i shkollës, në fund të vitit shkollor, ka shpallur pesë deri në dhjetë nxënësit e shkollës me rezultate vjetore më të larta.		
Kreu XIII, Neni 74, Pika 2	Drejtori i shkollës, pas konsultimit me këshillin e mësuesve, ka shpallur në fillim të vitit shkollor, nxënësit që në vitin shkollor paraardhës janë shquar për kontribute në		

	mbarëvajtjen e shkollës ose për ngjarje të spikatura në të cilat nxënësi është dalluar.		
Kreu XIII, Neni 74, Pika 3	Në rregulloren e brendshme të IA-së, janë parashikuar nderime dhe shpërblime për nxënësit me merita të veçanta.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika I/1, Gërma a	Kur nxënësi i klasave I-III ka munguar për një periudhë të vitit mësimor, mësuesi ka zbatuar një program individual për nxënësin gjatë kohës që është kthyer në shkollë.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika I/1, Gërma b	Kur nxënësi i klasave I-III ka munguar për një periudhë të vitit mësimor, mësuesi në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit, ka hartuar planin e punës së tyre me fëmijën, gjatë periudhës që fëmija ka munguar në shkollë dhe gjatë pushimeve verore.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika I/2	Mësuesi i klasave I-III, në fillim të vitit shkollor pasues, ka vlerësuar arritjen nga nxënësi të rezultateve të të nxënës, të programeve lëndore të klasës paraardhëse dhe, sipas rastit, ka vazhduar me program individual.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika II/1	Nxënësi i klasave IV-IX, që ka munguar 35% të orëve vjetore lëndore, është vlerësuar me shkrim nga mësuesi i lëndës, për ato njohuri dhe koncepte, në të cilat ai ka munguar. Në këtë rast, mësuesi ka vendosur një kolonë me vijë të kuqe në faqen e regjistrit “Datat, mungesat, temat e mësimit”, dhe në krye të saj ka shënuar “35%”, ndërsa te nxënësi që ka munguar 35% të orëve të lëndës, ka shënuar notën me të cilën ai vlerësohet për temat që ka munguar. Kjo notë, së bashku me notat e tjera të vlerësimit të vazhduar që ka marrë nxënësi përgjatë tri periudhave, është llogaritur për të nxjerrë notën notën e vlerësimit të vazhduar në kolonën “Vlerësimet vjetore”. Pjesa tjetër e vlerësimit është bërë si për të gjithë nxënësit e tjerë. Datat e vlerësimit janë caktuar nga mësuesi lëndor, në bashkëpunim me personin që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit dhe me miratimin e drejtorit të IA-së.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika II/2	Kur nxënësi i klasave IV-IX ka munguar më shumë se 35% të orëve vjetore lëndore, nuk është klasifikuar në atë lëndë. Në këtë rast, mësuesi i lëndës, pas datës së fundit të vitit mësimor, ka vendosur një kolonë me vijë të kuqe në faqen e regjistrit “Datat, mungesat, temat e mësimit”, dhe në krye të saj ka shënuar “Mbi 35%”, ndërsa te nxënësi që ka munguar mbi 35% të orëve të lëndës ka shënuar, “PK” (i paklasifikuar). PK, gjithashtu, është vendosur edhe në faqen e regjistrit “Vlerësimet periodike dhe vlerësimi përfundimtar”, në kolonën “Nota përfundimtare”, si dhe në lëndën përkatëse në faqen “Notat përfundimtare të nxënësve për të gjitha lëndët”. Nxënësit të paklasifikuar në një deri dy lëndë, i është dhënë		



	e drejta t'i japë këto lëndë në sesionin e dytë.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika II/3	Nxënësit e klasave IV-IX, të cilëve shkolla u ka krijuar kushte për mësimin në shtëpi nga mësues të caktuar, pas kthimit në shkollë u janë nënshtruar provimeve për orët e munguara, në data të caktuara nga mësuesi dhe të miratuara nga drejtori.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika II/4	Kur nxënësi i klasave IV-IX ka munguar më shumë se 50% të orëve totale vjetore të planit mësimor, është mbetur në klasë dhe ka përsëritur vitin. Janë përjashtuar nga ky rregull nxënësit me aftësi të kufizuara, për të cilët vendimin e ka marrë komisioni i IA-së për aftësinë e kufizuar.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika III/1	Në arsimin e mesëm të lartë, kur nxënësi ka munguar 30% të orëve vjetore lëndore, është vlerësuar me shkrim nga mësuesi i lëndës, për ato njohuri dhe koncepte mësimore, në të cilat ai ka munguar. Në këtë rast, mësuesi ka vendosur një kolonë me vijë të kuqe në faqen e regjistrit "Datat, mungesat, temat e mësimit", dhe në krye të saj ka shënuar "30%", ndërsa te nxënësi që ka munguar 30% të orëve të lëndës, ka shënuar notën me të cilën ai është vlerësuar për temat që ka munguar. Kjo notë, së bashku me notat e tjera të vlerësimit të vazhduar që ka marrë nxënësi përgjatë tri periudhave, është llogaritur për të nxjerrë notën e vlerësimit të vazhduar në kolonën "Vlerësimet vjetore". Pjesa tjetër e vlerësimit është bërë si për të gjithë nxënësit e tjerë. Datat e vlerësimit janë caktuar nga mësuesi lëndor, në bashkëpunim me personin që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, dhe me miratimin e drejtorit të IA-së.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika III/2	Në arsimin e mesëm të lartë, kur nxënësi ka munguar më shumë se 30% të orëve vjetore lëndore, nuk është klasifikuar në atë lëndë. Në këtë rast, mësuesi i lëndës, pas datës së fundit të vitit mësimor, ka vendosur një kolonë me vijë të kuqe në faqen e regjistrit "Datat, mungesat, temat e mësimit", dhe në krye të saj ka shënuar "Mbi 30%", ndërsa te nxënësi që ka munguar mbi 30% të orëve të lëndës, ka shënuar "PK" (i paklasifikuar). PK, gjithashtu, është vendosur edhe në faqen e regjistrit "Vlerësimet periodike dhe vlerësimi përfundimtar", në kolonën "Nota përfundimtare", si dhe në lëndën përkatëse në faqen "Notat përfundimtare të nxënësve për të gjitha lëndët". Vlerësimi i lëndës ka vazhduar në sesionin e dytë. Janë përjashtuar nga ky rregull nxënësin me AK, për të cilët vendimin e ka marrë komisioni i IA-së për aftësinë e kufizuar.		

Kreu XIII, Neni 75, Pika III/3	Nxënësit e klasave X-XII, të cilëve shkolla u ka krijuar kushte për mësimin në shtëpi nga mësues të caktuar, pas kthimit në shkollë u janë nënshtruar provimeve për orët e munguara, në data të caktuara nga mësuesi dhe të miratuara nga drejtori.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika III/4	Në arsimin e mesëm të lartë, kur nxënësi ka munguar më shumë se 30% të orëve totale vjetore të planit mësimor, është mbetur në klasë. Janë përjashtuar nga ky rregull nxënësit me AK, për të cilët vendimin e ka marrë komisioni i IA-së për aftësinë e kufizuar.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika III/5, Gërma a	Drejtori i shkollës së arsimit të mesëm të lartë ka paralajmëruar me shkrim, për përjashtim nga shkolla, nxënësin që ka munguar pa arsye 30 orë mësimore, si dhe ka njoftuar me shkrim personin që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, përmes shërbimit postar me lajmërimarrje apo forma të tjera të parashikuara në legjislacionin përkatës në fuqi të RSH-së.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika III/5, Gërma b	Drejtori i shkollës së arsimit të mesëm të lartë ka përjashtuar nga shkolla për atë vit shkollor, nxënësin që ka kryer edhe 15 orë të tjera mësimore pa arsye, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, si dhe ka njoftuar me shkrim personin që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, përmes shërbimit postar me lajmërimarrje apo formave të tjera të parashikuara në legjislacionin përkatës në fuqi të RSH-së. Masa ndaj nxënësit është ruajtur në arkivin e shkollës për 3 vjet.		
Kreu XIII, Neni 75, Pika III/6	Nxënësi i arsimit të mesëm të lartë që ka ndërprerë vazhdimin e një klase, është regjistruar në atë klasë, në qoftë se ka plotësuar kriteret e moshës së përcaktuar në ligj.		
Kreu XIII, Neni 76, Pika 1	Institucioni i arsimit bazë ka konsideruar potencialisht braktisës nxënësin e regjistruar në shkollë në fillim të vitit shkollor dhe në fillim të javës së tretë të muajit tetor është raportuar nga shkolla si i paparaqitur.		
Kreu XIII, Neni 76, Pika 2, Gërma a	Institucioni i arsimit bazë ka konsideruar braktisës nxënësin që është regjistruar shkollë në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të vitit shkollor ka rezultuar i paklasifikuar (mbetës) për shkak të mungesave.		
Kreu XIII, Neni 76, Pika 2, Gërma b	Institucioni i arsimit bazë ka konsideruar braktisës nxënësin, kur mungesat e paarsyeshme nuk kanë përmbushur asnjë prej kushteve si: fatkeqësi familjare, sëmundje që zgjat shumë ose që shkakton mungesa të rregullta (dokumentuar me raport mjeko-ligjor), transferimi në një shkollë tjetër brenda dhe jashtë vendit (i dokumentuar), migrimi jashtë vendit (i dokumentuar),		

	vdekja.		
Kreu XIII, Neni 76, Pika 3	Drejtori i shkollës së arsimit bazë ka njoftuar me shkresë titullarin e ZVA-së dhe personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për nxënësin që i përket shkollës së tij dhe nuk është regjistruar në shkollë ose nxënësin, që mungon më shumë se 10 ditë mësimi, pa ndonjë arsye të vlefshme. Titullari i ZVA-së, me të dhënat e paraqitura nga drejtori i IA-së, ka njoftuar me shkresë bashkinë, ku nxënësi banon.		
Kreu XIII, Neni 77, Pika 1	Institucioni arsimor i ka konsideruar të arsyeshme mungesat e nxënësit të justifikuara me raport mjekësor, ose nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore për arsye të jashtëzakonshme, ose kur ka kërkuar leje paraprakisht me një shënim sqarues dhe i është miratuar nga mësuesi kujdestar.		
Kreu XIII, Neni 77, Pika 2	Mësuesi kujdestar ka vlerësuar si të arsyeshme/të paarsyeshme mungesat e nxënësit deri në tri ditë mësimi gjatë një muaji. Mungesat më të gjata se tri ditë, janë miratuar me shkrim nga drejtori/nëndrejtori i IA-së dhe i janë dorëzuar mësuesit kujdestar.		
Kreu XIII, Neni 77, Pika 3	Mësuesi kujdestar, brenda javës së parë të çdo muaji, i ka dorëzuar drejtorit/nëndrejtorit të IA-së tabelën e mungesave mujore të klasës, të ndara në: gjithsej, të arsyetuara, të paarsyetuara, mungesa 1-3 orëshe, të cilat janë dokumentuar në regjistër.		
Kreu XIII, Neni 77, Pika 4, Gërma a	Drejtori/nëndrejtori ka hartuar tabelën e të dhënave mujore të mungesave të shkollës, dhe i ka renditur klasat sipas treguesit: “Numri i mungesave për nxënës”, rumbullakosur me një shifër pas presjes dhjetore.		
Kreu XIII, Neni 77, Pika 4, Gërma b	Drejtori/nëndrejtori ka hartuar tabelën e të dhënave mujore të mungesave të shkollës dhe i ka renditur klasat sipas treguesit: “Përqindja e mungesave 1-3 orëshe kundrejt të gjitha orëve”, rumbullakosur me një shifër pas presjes dhjetore.		
Kreu XIII, Neni 77, Pika 5	Institucioni arsimor ka afishuar në një vend të dukshëm për nxënësit, tabelën e renditjes së klasave, sipas numrit të mungesave.		
Kreu XIII, Neni 77, Pika 6	Drejtorja e IA-së ka zhvilluar mbledhje të posaçme për mungesat e nxënësve në tërësi ose për klasa të veçanta, sipas gjendjes shqetësuese të mungesave.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 1	Transferimi i nxënësit është bërë (si rregull) pas përfundimit të vitit shkollor ose pas përfundimit të njërit prej tremujorëve, kurse në raste të ndërrimit të vendbanimit të tij gjatë vitit shkollor.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 2	Nxënësi është transferuar nga një shkollë me konkurs në një tjetër të të njëjtit profil, pas përfundimit të vitit të parë		

	shkollor.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 3	Kërkesa për transferim është formuluar me shkrim nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit dhe i është drejtuar drejtorit të IA-së ku nxënësi është regjistruar.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 4	Drejtori i IA-së ka nënshkruar dhe ka vulosur dokumentacionin e transferimit, ia ka dorëzuar personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit dhe ia ka dërguar zyrtarisht drejtorit të IA-së pritëse.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 5, Gërma a	Dokumentacioni i transferimit përmban vlerësimet/notat e nxënësit të marra gjatë vitit shkollor deri në çastin e transferimit.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 5, Gërma b	Dokumentacioni i transferimit përmban numrin e mungesave të arsyetuara dhe të paarsyetuara.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 5, Gërma c	Dokumentacioni i transferimit përmban nderimet ose/dhe masat disiplinore të marra nga nxënësi.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 6	Drejtori i IA-së, ku është transferuar nxënësi, ka njoftuar, menjëherë, zyrtarisht për regjistrimin, drejtorin e IA-së nga vjen nxënësi. Drejtori i shkollës dërguese, pas këtij njoftimi, ka bërë çregjistrimin e nxënësit.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 7	IA-ja ka pasqyruar lëvizjet e nxënësve në regjistrin e klasës dhe në amzë. Procedurat e lëvizjes janë bërë në përputhje me formatin në shtojcën nr. 8, të kësaj Rregulloreje.XIII		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 8	Kur nxënësi ka përfunduar një klasë të arsimit bazë, regjistrimi i tij në shkollën tjetër është bërë mbi bazën e vërtetimit të përfundimit të klasës paraardhëse, në të cilin është shënuar dhe numri i amzës, i nënshkruar dhe i vulosur nga drejtori i shkollës, ku nxënësi ka përfunduar klasën përkatëse.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 9	Nxënësi i arsimit bazë artistike, i cili ka në sesionin e dytë ka qenë jokalues në lëndë të profilit artistik, është transferuar në klasën pasardhëse të arsimit bazë të zakonshëm, pasi ka plotësuar lëndët që nuk i ka zhvilluar në shkollën artistike dhe pasi ka marrë miratimin e titullarit të ZVA-së.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 10	Transferimi i nxënësit të shkollës së arsimit të mesëm të lartë në një shkollë të një profili tjetër, është bërë pasi ka përfunduar viti shkollor dhe pasi ka marrë miratimin e ZVA-së. Nxënësi ka shlyer detyrimet që rrjedhin nga ndryshimet në planet mësimore e programet lëndore të shkollave, në përputhje me njëvlershmërinë e përcaktuar me udhëzime të posaçëm.		

	Drejtori i IA-së ka caktuar datat e provimeve.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 11	Ndërimi i gjimnazit gjatë vitit shkollor, kur të dy gjimnazet janë brenda një qyteti, është lejuar vetëm në raste të veçanta, me shkresë të ZVA-së, dërguar dy gjimnazeve, duke respektuar kriterin e gjuhës së huaj të parë dhe lëndëve me zgjedhje.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 12	Institucioni i arsimit të mesëm të lartë ka regjistruar nxënësin e një shkolle tjetër, mbi bazën e vërtetimit me notat e të gjitha klasave paraardhëse.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 13	Nxënësi është transferuar nga shkolla e arsimit të mesëm profesional në gjimnaz vetëm pas vitit të parë shkollor dhe pasi nxënësi ka kaluar provimet e njëvlershmërisë, të përcaktuara me udhëzim të ministrit.		
Kreu XIII, Neni 78, Pika 14	Transferimi i nxënësit nga arsimit të mesëm me kohë të pjeshme në arsimin mesëm me kohë të plotë nuk është lejuar në asnjë rast.		
Kreu XIII, Neni 79, Pika 1	Drejtorja e shkollës së arsimit bazë ka organizuar me nxënësit e klasës së nëntë dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre: a) takime me punonjës arsimorë të shkollave të arsimit të mesëm të lartë; b) vizita në mjedise të mundshme për punësim.		
Kreu XIII, Neni 79, Pika 2	Drejtorja e shkollës së arsimit të mesëm të lartë ka organizuar me nxënësit e vitit të fundit dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre: a) takime me pedagogë të degëve të institucioneve të arsimit të lartë; b) vizita në mjedise të mundshme për punësim.		

**KREU XIV**  
**ARSIMIMI I FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu XIV, Neni 80, Pika 1	ZVA-ja ka ngritur komisionin multidisiplinar të përbërë nga: një mjek pediatër (kur është e mundur mjek pediatër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i Njësisë së Shërbimit Psiko-social. Kryetar i komisionit është drejtuesi i NjShPS-së.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 2	ZVA-ja, bazuar te numri i IA-ve që mbulon dhe numri i nxënësve me AK, ka ngritur më shumë se një komision për mbulimin në kohë të nevojave për vlerësim.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 3	Komisioni, me kërkesën e personit që ushtron		

	përgjegjësinë prindërore të fëmijës, ose të drejtorit të IA-së, ka vlerësuar nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 4	Komisioni është mbledhur tri herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të periudhës së parë dhe në fund të vitit mësimor.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 5	Drejtori i IA-së është këshilluar me komisionin e institucionit, para se t'i drejtohet komisionit të ZVA-së për fëmijët me AK dhe ka bashkëpunuar me personin që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës, për të paraqitur kërkesën e tij.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 6	Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, i ka paraqitur ZVA-së raportin vlerësues të fëmijës së tij, të kryer nga komisioni mjekësor (kur fëmija është vlerësuar nga komisioni mjekësor).		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 7, Gërma a	Komisioni ka njoftuar personin që ushtron përgjegjësinë prindërore, mbi gjendjen dhe ecurinë e fëmijës.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 7, Gërma b	Komisioni i ka dhënë me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar, ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 7, Gërma c	Komisioni ka rekomanduar shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 7, Gërma ç	Komisioni ka rekomanduar pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor, nëse fëmija nuk e ka.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 8	Vlerësimi dhe praktika e punës së komisionit është mbështetur në klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 9	Komisioni ka ftuar, të paktën, një prind gjatë vlerësimit të fëmijës dhe, nëse ka qenë e nevojshme, të afërm të tij. Kur fëmija është në kopsht/shkollë, përveç personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, kanë marrë pjesë: punonjësi i shërbimit psiko-social në IA dhe mësuesi i fëmijës të caktuar nga drejtori i IA-së.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 10	Komisioni ka rekomanduar ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur ka gjykuar se një shkollë e zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën AK.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 11	Komisioni ka njoftuar me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët fëmijë me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale, si dhe ka rekomanduar mjetet ndihmëse, që i nevojiten fëmijës për të realizuar procesin mësimor-edukativ.		

Kreu XIV, Neni 80, Pika 12	Komisioni i ZVA-së ka udhëzuar komisionet e IA-ve për punën me nxënësit me AK.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 13	Komisioni i ZVA-së ka mbajtur dokumentacionin e gjendjes fillestare të fëmijës me AK dhe ka përditësuar ecurinë e tij në bashkëpunim me komisionin e IA-së.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 14	ZVA-ja ka siguruar kushtet e përshtatshme për ushtrimin e punës së komisionit.		
Kreu XIV, Neni 80, Pika 15	ZVA-ja ka vënë në dispozicion të komisionit dokumentacionin e fëmijëve që do të vlerësojë, të paktën dy javë para vlerësimit.		
Kreu XIV, Neni 81, Pika 1, Gërma a	ZVA-ja ka siguruar arsimimin e fëmijëve me AK në një IA publike të zakonshëm ose të specializuar.		
Kreu XIV, Neni 81, Pika 1, Gërma b	ZVA-ja ka siguruar arsimimin në shtëpi të nxënësve me AK, të cilët nuk mund të ndjekin shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë.		
Kreu XIV, Neni 81, Pika 2	ZVA-ja, bazuar në rekomandimin e komisionit multidisiplinar, ka caktuar mësuesin ndihmës për fëmijët me AK, sipas nevojave individuale të tyre.		
Kreu XIV, Neni 81, Pika 3	ZVA-ja ka informuar IA-të publike për shërbimet rehabilituese, të ofruara nga institucionet shtetërore shëndetësore.		
Kreu XIV, Neni 81, Pika 4	ZVA-ja ka pajisur me përparësi nxënësit me AK, me mjete mësimore dhe pajisje ndihmëse, për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe zhvillimin e tyre personal e ndërpersonal.		
Kreu XIV, Neni 81, Pika 5	ZVA-ja ka organizuar, nëpërmjet NjShPS-së, bashkëpunimin e mësuesve të shkollave të specializuara me mësuesit e shkollave të zakonshme, për hartimin dhe vënien në jetë të planeve edukative individuale (PEI) për nxënësit me AK.		
Kreu XIV, Neni 82, Pika 1	ZVA-ja ka caktuar mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në IA-të publike.		
Kreu XIV, Neni 82, Pika 2, Gërma a	Mësuesi ndihmës ka dhënë ndihmesën e tij për zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik të nxënësve me AK.		
Kreu XIV, Neni 82, Pika 2, Gërma b	Mësuesi ndihmës ka bashkëpunuar me mësuesin ose mësuesit lëndorë, mësuesin kujdestar dhe psikologun/punonjësin social për gjithëpërfshirjen e nxënësve me AK në IA-të e zakonshme.		
Kreu XIV, Neni 82, Pika 2, Gërma c	Mësuesi ndihmës ka asistuar nxënësin me AK, sipas nevojave gjatë procesit mësimor, brenda dhe jashtë klase, për të bërë të mundur pjesëmarrjen e tij sa më të plotë në veprimtaritë shkollore.		
Kreu XIV, Neni 82, Pika 2, Gërma ç	Mësuesi ndihmës ka punuar me nxënësit me AK krahas mësuesit në të gjitha orët mësimore vjetore apo në një pjesë të tyre, gjithashtu jashtë klasës, me nxënës të veçantë		

	me AK, ose me grupe të vogla, duke parapëlqyer grupimet e klasave I-III, IV-V dhe VI-IX.		
Kreu XIV, Neni 82, Pika 2, Gërma d	Mësuesi ndihmës ka hartuar në bashkëpunim me mësuesin e nxënësit me AK/mësuesit lëndorë dhe personin që ushtron përgjegjësinë prindërore, dhe ka zbatuar programin edukativ individual (PEI) të nxënësit, i cili është miratuar nga komisioni i IA-së për fëmijët me AK.		
Kreu XIV, Neni 83, Pika 1	Drejtori i IA-së së zakonshme ka ngritur komisionin për nxënësit me AK, i përbërë nga tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënët dhe psikologu/punonjësi social. Në komision ka marrë pjesë të paktën një nga mësuesit e nxënësit me AK dhe mësuesi ndihmës (kur ka). Kryetar i komisionit është caktuar punonjësi i shërbimit psiko-social.		
Kreu XIV, Neni 83, Pika 2, Gërma a	Komisioni i IA-së së zakonshme, bazuar në vlerësimin e komisionit të ZVA-së, ka udhëzuar mësuesit për hartimin e PEI-t dhe i ka miratuar ato.		
Kreu XIV, Neni 83, Pika 2, Gërma b	Komisioni i IA-së së zakonshme ka ndihmuar mësuesit për zbatimin e PEI-t.		
Kreu XIV, Neni 83, Pika 2, Gërma c	Komisioni i IA-së së zakonshme ka ndjekur ecurinë e fëmijëve me AK.		
Kreu XIV, Neni 83, Pika 2, Gërma ç	Komisioni i IA-së së zakonshme ka paraqitur në komisionin e ZVA-së raportin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas formatit të vendosur nga komisioni i ZVA-së.		
Kreu XIV, Neni 83, Pika 3	Anëtarët e komisionit në ZVA dhe në IA, mësuesit dhe mësuesit ndihmës që punojnë me fëmijën me AK, nuk u kanë dhënë të dhënat personale të këtyre fëmijëve, personave të paautorizuar nga komisioni i ZVA-së/drejtori i IA-së.		
Kreu XIV, Neni 84, Pika 1	Shkolla e specializuar ka pranuar në klasën e parë fëmijët me AK të moshës 6-10 vjeç. Nxënësi me AK është lejuar të qëndrojë në shkollën e specializuar deri në moshën 19 vjeç. Pranimi i nxënësve me AK në klasën e parë të shkollave të zakonshme ka filluar nga mosha 6 vjeç.		
Kreu XIV, Neni 84, Pika 2	Nxënësi me AK është regjistruar në shkollë me të njëjtin dokumentacion si ai i nxënësve të tjerë.		
Kreu XIV, Neni 84, Pika 3	Transferimi i nxënësit me AK nga një IA-ja e zakonshme në një tjetër është bërë sipas procedurave të transferimit të nxënësve, të përshkruar në këtë Rregullore. Në shkollën pritëse është dorëzuar një raport i hartuar nga komisioni i IA-së dhe i nënshkruar nga drejtori i shkollës, ku është paraqitur PEI dhe ecuria e nxënësit në realizimin e tij.		



Kreu XIV, Neni 84, Pika 4	Vlerësimi i nxënësve me AK është bërë si ai i nxënësve të tjerë. Nxënësit me AK me PEI janë vlerësuar në përputhje me objektivat e vendosur në PEI-në përkatës.		
Kreu XIV, Neni 84, Pika 5	Nxënësit me AK e kanë përsëritur klasën në raste të veçanta, kur komisioni i IA-së dhe personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, kanë çmuar dobinë e përsëritjes.		
Kreu XIV, Neni 84, Pika 6	Nxënësi me AK, pas përfundimit të çdo klase, është pajisur me dëftesë që përmban një rubrikë ku përshkruhen përmbledhtas objektivat kryesorë të PEI-t të tij.		
Kreu XIV, Neni 84, Pika 7	Nxënësi me AK ka zhvilluar provimet në përshtatje me veçoritë e tij.		
Kreu XIV, Neni 84, Pika 8	Nxënësit me AK që nuk kanë mësuar me programet e zakonshme lëndore, i janë nënshtruar një provimi të posaçëm kombëtar të arsimit bazë dhe të Maturës Shtetërore.		
Kreu XIV, Neni 84, Pika 9	Nxënësi me AK ka zhvilluar provimet kombëtare, bazuar te testet e hartuara nga QSHA-ja.		
Kreu XIV, Neni 84, Pika 10	Nxënësi me AK që ka përfunduar me sukses provimet kombëtare të arsimit bazë, është pajisur me dëftesën e posaçme.		
Kreu XIV, Neni 85, Pika 1	Nxënësve që nuk dëgjojnë e nuk flasin u është garantuar e drejta e arsimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë përdorimi i shkrimit Brail. Materialet mësimore ndihmëse janë përshtatur sipas formatit (në “Brail”, tekste me shkronja të mëdha etj.). Kur ka qenë e nevojshme janë përdorur versione të thjeshtuara të tekstit të lëndës mësimore.		
Kreu XIV, Neni 85, Pika 2	Nxënësit që nuk shikojnë apo nuk flasin ose/dhe nuk dëgjojnë, e zhvillojnë mësimin duke u bazuar përgjithësisht në kurrikulën e zakonshme.		
Kreu XIV, Neni 85, Pika 3	Me rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar të ZVA-së, nxënësve që nuk shikojnë apo nuk flasin ose/dhe nuk dëgjojnë, u janë siguruar tekste për mësimin e gjuhës së folur dhe komunikimin global.		
Kreu XIV, Neni 86, Pika 1	Mësuesit e shkollave të specializuara janë të diplomuar në arsimin special.		
Kreu XIV, Neni 86, Pika 2	Shkolla e specializuar ka punonjës të specializuar në aftësinë e kufizuar, që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara (mjekë, punonjës të shërbimit psiko-social, terapistë), si dhe mësues ndihmës.		
Kreu XIV, Neni 86, Pika 3	Nxënësit që sipas komisionit të vlerësimit në ZVA kanë nevojë për trajtim të individualizuar, punojnë me PEI.		
Kreu XIV, Neni 86, Pika 4	Shkollat e specializuara nën organizimin e ZVA-ve kanë shërbyer si qendër shkëmbimi përvojë për mësuesit e IA-ve të zakonshme që punojnë me fëmijë me AK.		

Kreu XIV, Neni 86, Pika 5	Shkollat speciale kanë shërbyer si qendra burimore për shkollat e zakonshme, duke ndihmuar personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve, mësuesit ndihmës dhe mësuesit e IA-ve të zakonshme që kanë nxënës me AK.		
Kreu XIV, Neni 87, Pika 1	Emërimi dhe largimi nga puna i mësuesit dhe mësuesit ndihmës në shkollat e specializuara është kryer sipas procedurave për mësuesit në IA-të e zakonshme.		
Kreu XIV, Neni 87, Pika 2	Drejtori i IA-së ka vendosur kalimin nga mësues ndihmës në mësues, pas këshillimit me këshillin e mësuesve.		
Kreu XIV, Neni 88, Pika 1	Çdo mësues ndihmës ka në varësi një klasë nxënësish. Shkolla e specializuar ka përshkruar në rregulloren e brendshme të saj detyrat e mësuesit ndihmës.		

**KREU XV**  
**PERSONAT QË USHTROJNË PËRGJEGJËSINË PRINDËRORE**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu XV, Neni 88, Pika 1 Gërma a	Në sistemin arsimor parauniversitar është garantuar e drejta e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe e përfaqësuesve të tyre ligjorë për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t'u dëgjuar për këto pikëpamje.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 1 Gërma b	Në sistemin arsimor parauniversitar është garantuar e drejta e organizimit të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për të mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe për të dhënë ndihmesën në rimbartëvajtjen e IA-së.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 2	IA-ja ka informuar personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për: a) legjislacionin në fuqi; b) kurrikulën që ofron institucioni; c) rregulloren e brendshme të institucionit; ç) kushtet e sigurisë, të shëndetit dhe të mjedisit të institucionit; d) veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe pëlqimin për veprimtaritë plotësuese jashtëshkollore të fëmijës, si dhe ekskursionet që ajo organizon; dh) drejtimet kryesore të veprimtarisë së saj dhe arritjet e institucionit në raport me institucione të ngjashme; e) të drejtat dhe detyrimet e tyre; ë) masat disiplinore për nxënësit; f) procedurat e ankimit; g) procedurat e zhdëmtimeve.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 3	IA-ja ka marrë në konsideratë propozimet e personave që		

	ushtrjnë përgjegjësi prindërore për përmirësimin e shërbimit arsimor në nivel institucioni/klase.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 4, Gërma a	Personi që ushtron përgjegjësi prindërore është kujdesur që fëmija i tij të ndjekë rregullisht IA-në dhe të mësojë rregullisht.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 4, Gërma b	Personi që ushtron përgjegjësi prindërore ka njoftuar mësuesin kujdestar për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 4, Gërma c	Personi që ushtron përgjegjësi prindërore ka marrë pjesë në takimet për çështje që kanë të bëjnë me fëmijën e tij.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 4, Gërma ç	Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka njoftuar mësuesin kujdestar, në rastet kur fëmija i tij ka munguar dhe i ka arsyetuar këto mungesa.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 4, Gërma d	Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka marrë pjesë në takimet që janë zhvilluar me personat që ushtrjnë përgjegjësinë prindërore.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 4, Gërma dh	Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore ka kontribuar në mbarëvajtjen e IA-së.		
Kreu XV, Neni 88, Pika 5	<p>Personat që ushtrjnë përgjegjësinë prindërore kanë vendosur nëse fëmija me AK, mbi të cilin ushtrjnë përgjegjësinë prindërore, do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë.</p> <p>IA-ja e zakonshme ka hartuar PEI-in për nxënësin me AK në bashkëpunim me personat që ushtrjnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit.</p> <p>Ndryshimi i PEI-it brenda IA-së është vendosur nga komisioni i institucionit, në bashkëpunim me personat që ushtrjnë përgjegjësinë prindërore të fëmijës.</p>		
Kreu XV, Neni 88, Pika 6	Drejtori i IA-së ose mësuesi kujdestar kanë njoftuar personin që ushtron përgjegjësinë prindërore dhe kanë kërkuar lejen e tij me shkrim për veprimtaritë e nxënësit jashtë orarit mësimor.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 1	Këshilli i prindërve të IA-së është i përbërë nga përfaqësues të personave që ushtrjnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve të IA-së.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 2, Gërma a	Këshilli i prindërve të IA-së ka mbrojtur dhe ka promovuar të drejtat e personave që ushtrjnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve të institucionit.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 2, Gërma b	Këshilli i prindërve të IA-së ka shprehur pikëpamjet dhe ka organizuar personat që ushtrjnë përgjegjësinë prindërore për të shprehur pikëpamjet për cilësinë e shërbimit arsimor të ofruar.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 2, Gërma c	Këshilli i prindërve të IA-së ka zhvilluar mbledhjen e përgjithshme të personave që ushtrjnë përgjegjësinë prindërore.		

Kreu XV, Neni 89, Pika 3, Gërma a	Këshilli i prindërve të IA-së ka ndërmarrë nisma për ndihmesën e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, për mbarëvajtjen e institucionit dhe i ka realizuar ato në bashkëpunim me drejtorinë e institucionit.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 3, Gërma b	Këshilli i prindërve të IA-së ka organizuar takime të përbashkëta me këshillat e prindërve të klasave.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 4	Këshilli i prindërve të IA-së përbëhet nga persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të zgjedhur nga këshillat e klasave. Numri i personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në këshillin e prindërve është përcaktuar në rregulloren e brendshme të IA-së, përkatësisht nga gjashtë deri në nëntë anëtarë.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 5	Kryetari i këshillit të prindërve të IA-së është zgjedhur në mbledhjen e parë të këshillit me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të këshillit, ndërmjet kandidatëve për këtë detyrë.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 6	Kryetari dhe anëtarët e këshillit të prindërve të IA-së nuk janë në konflikt interesi me drejtorin e institucionit, nuk kanë precedentë penalë dhe nuk janë në forumet drejtuese të partive politike.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 7	Në mbledhjen e parë janë përcaktuar detyrat e anëtarëve të këshillit të prindërve.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 8	Zgjedhjet për këshillin e prindërve të IA-së dhe kryetarin e tij janë zhvilluar çdo vit, në fillim të vitit shkollor.		
Kreu XV, Neni 89, Pika 9	Në këshillin pasues të prindërve të institucionit janë lejuar të zgjidhen kryetari dhe anëtarët e vitit paraardhës.		
Kreu XV, Neni 90, Pika 1	Këshilli i prindërve të IA-së është mbledhur të paktën tri herë në vit. Mbledhjet e tjera janë zhvilluar me nismën e kryetarit të këshillit të prindërve ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij.		
Kreu XV, Neni 90, Pika 2	Mbledhjet e këshillit të prindërve të IA-së janë zhvilluar kur ka marrë pjesë shumica e thjeshtë e anëtarëve të tij, përndryshe është shtyrë.		
Kreu XV, Neni 90, Pika 3	Këshilli i prindërve i ka marrë vendimet me shumicë të thjeshtë votash. Vendimet janë nënshkruar nga kryetari dhe sekretari.		
Kreu XV, Neni 90, Pika 4	Kryetari i këshillit të prindërve ka ftuar në mbledhjet e këshillit të prindërve, anëtarë të këshillave të prindërve të klasave, persona të tjerë që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, drejtues dhe mësues të IA-së, përfaqësues të OJF-ve etj.		
Kreu XV, Neni 90, Pika 5	Veprimtaria e anëtarëve të këshillit të prindërve kryhet në mënyrë vullnetare.		
Kreu XV, Neni 90, Pika 6	Kryetari dhe anëtarët e këshillit të prindërve janë shkarkuar me shumicë të thjeshtë të votave të fshehta të anëtarëve për		

	moskryerje të detyrës ose kur kanë munguar në më shumë se gjysmën e mbledhjeve.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 1	Kryetari ka drejtuar veprimtarinë e këshillit të prindërve.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 2	Kryetari ka caktuar një anëtar të këshillit të prindërve për të kryer funksionin e sekretarit.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 3, Gërma a	Sekretari i këshillit të prindërve ka përgatitur materialet e mbledhjes.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 3, Gërma b	Sekretari ka mbajtur procesverbalin e mbledhjeve të këshillit të prindërve.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 3, Gërma c	Sekretari i këshillit të prindërve ka lajmëruar anëtarët dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 3, Gërma ç	Sekretari i këshillit të prindërve ka mbajtur arkivin e këshillit të prindërve.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 4, Gërma a	Drejtori i IA-së i ka dorëzuar kryetarit të këshillit të prindërve kopje të dokumenteve ligjore mbi veprimtarinë e IA-së.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 4, Gërma b	Drejtori i IA-së i ka dorëzuar kryetarit të këshillit të prindërve raporte të institucioneve përgjegjëse për vlerësimin dhe raportimin e cilësisë së shërbimit arsimor të IA-së.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 4, Gërma c	Drejtori i IA-së ka informuar këshillin e prindërve për rezultatet e IA-së në provimet/vlerësimet kombëtare/ndërkombëtare apo olimpiadat, duke pasur parasysh mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 4, Gërma ç	Drejtori i IA-së ka informuar këshillin e prindërve për raportet publike të provimeve/vlerësimeve kombëtare/ndërkombëtare, si dhe për çdo studim krahasues të IA-së me institucionet e tjera arsimore.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 4, Gërma d	Drejtori i IA-së ka organizuar, të paktën një herë në vit, mbledhje të përbashkëta të këshillit të mësuesve me këshillin e prindërve të institucionit.		
Kreu XV, Neni 91, Pika 4, Gërma dh	Drejtori i IA-së ka siguruar për këshillit të prindërve një mjedis për zhvillimin e takimeve të tij.		
Kreu XV, Neni 92, Pika 1	Këshilli i prindërve të klasës ka ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor për nxënësit e klasës.		
Kreu XV, Neni 92, Pika 2	Për çdo klasë, brenda 10 ditëve nga data e fillimit të vitit shkollor, me përkujdesjen e mësuesit kujdestar, është zhvilluar mbledhja e përgjithshme e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve të klasës, ku është zgjedhur, me shumicë të thjeshtë votash, këshilli i prindërve të klasës, me përbërje nga tre deri në pesë veta. Kryetari i këshillit të prindërve të klasës është zgjedhur prej këtij këshilli.		
Kreu XV, Neni 92, Pika 3	Këshilli i prindërve të klasës është mbledhur, të paktën një herë në dy muaj, sipas një tematike të planifikuar prej tij, ose me propozimin e mësuesit kujdestar.		

	Këshilli i prindërve të klasës është mbledhur me nismën e tij edhe më shpesh.		
Kreu XV, Neni 92, Pika 4, Gërma a	Këshilli i prindërve të klasës i ka propozuar mësuesit kujdestar përmirësime në mbarëvajtjen e nxënësve të klasës.		
Kreu XV, Neni 92, Pika 4, Gërma b	Këshilli i prindërve të klasës ka marrë në konsideratë mendimet e mësuesit kujdestar dhe i ka dhënë këshilla ose ka bashkëpunuar me të.		
Kreu XV, Neni 92, Pika 4, Gërma c	Këshilli i prindërve të klasës ka komunikuar me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve që rrezikojnë braktisjen e shkollës, ose mbetjen në klasë, ose që kryejnë shkelje të disiplinës.		
Kreu XV, Neni 92, Pika 5	Këshilli i prindërve të klasës ka nxitur personat që ushtrojnë përgjegjësi prindërore të nxënësve të japin ndihmesën e tyre vullnetare: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) për të punuar me nxënësit me vështirësi në të nxënë;</li> <li>b) për hartuar ose/dhe për të vënë në jetë lëndë/module me zgjedhje;</li> <li>c) për të bashkëpunuar në projekte kurrikulare.</li> </ul>		
Kreu XV, Neni 92, Pika 6	Këshilli i prindërve të klasës ka ftuar në mbledhjet e tij mësues të tjerë të klasës, nxënës nga qeveria e nxënësve, anëtarë të drejtorisë, të bordit, të këshillit të mësuesve dhe të këshillit të prindërve të shkollës.		
Kreu XV, Neni 92, Pika 7	Këshilli i prindërve të klasës i është drejta për t'iu drejtuar drejtorit të IA-së, kryetarit të bordit dhe kryetarit të këshillit të prindërve të shkollës, me propozime për mbarëvajtjen e shkollës.		
Kreu XV, Neni 92, Pika 8	Kryetari i këshillit të prindërve të klasës ka raportuar në mbledhjen e përgjithshme të personave që ushtrojnë përgjegjësi prindërore të nxënësve të klasës, si rregull, dy herë gjatë vitit shkollor.		
Kreu XV, Neni 93, Pika 1, Gërma a	Këshilli Kombëtar i Prindërve, i përbërë nga përfaqësues të këshillave rajonale të prindërve, ka siguruar komunikimin ndërmjet ministrisë dhe personave që ushtrojnë përgjegjësi prindërore.		
Kreu XV, Neni 93, Pika 1, Gërma b	Këshilli Kombëtar i Prindërve ka përcjellë në ministri mendimet e tij për përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar.		
Kreu XV, Neni 93, Pika 1, Gërma c	Këshilli Kombëtar i Prindërve ka bashkëpunuar me ministrinë, Këshillin Rajonal të Prindërve, shoqatat e prindërve dhe me ZVA-të.		
Kreu XV, Neni 93, Pika 2, Gërma a	Këshilli Rajonal i Prindërve ka përfaqësuar interesat e nxënësve dhe personave që ushtrojnë përgjegjësi prindërore të tyre në institucionet e arsimit parauniversitar në nivel DRAP-i.		
Kreu XV, Neni 93, Pika 2, Gërma b	Këshilli Rajonal i Prindërve ka organizuar personat që ushtrojnë përgjegjësi prindërore për të mbështetur shkollën		

	dhe stafin në veprimtarinë edukative-arsimore.		
Kreu XV, Neni 93, Pika 2, Gërma c	Këshilli Rajonal i Prindërve ka krijuar mekanizmat e komunikimit ndërmjet këshillave të prindërve të IA-së dhe Këshillit Kombëtar të Prindërve.		
Kreu XV, Neni 93, Pika 3	Këshilli Kombëtar i Prindërve dhe këshillat rajonale të prindërve janë ngritur dhe funksionojnë bazuar në udhëzimin përkatës të ministrit.		

**KREU XVI**  
**MATURA SHTETËRORE, PROVIMET, VLERËSIMET KOMBËTARE DHE TESTET**  
**NDËRKOMBËTARE**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu XVI, Neni 94, Pika 1	Shkolla ka publikuar në këndin e konsultimeve, për secilën nga lëndët e MSh-së, provimeve/vlerësimeve kombëtare, orarin e konsultimeve, të cilat janë zhvilluar deri në përfundim të vitit mësimor dhe gjatë ditëve para çdo provimi, sipas akteve nënligjore në fuqi.		
Kreu XVI, Neni 94, Pika 2	DRAP-i dhe ZVA-ja kanë vëzhguar dhe kanë ndihmuar IA-në në organizimin dhe zhvillimin e konsultimeve.		
Kreu XVI, Neni 95, Pika 1	Nxënësi ka marrë pjesë në provimet e Maturës Shtetërore dhe në provimet kombëtare të arsimit bazë, kur ka plotësuar të gjitha detyrimet shkollore.		
Kreu XVI, Neni 95, Pika 2	Provimet/vlerësimet kombëtare janë zhvilluar vetëm me shkrim.		
Kreu XVI, Neni 96, Pika 1	Nxënësi që nuk është paraqitur ose nuk ka kaluar në sesionin e parë të provimeve të Maturës Shtetërore dhe provimeve kombëtare të arsimit bazë, i ka dhënë provim lëndën/lëndët në sesionin e dytë.		
Kreu XVI, Neni 96, Pika 2	Nxënësi, që është vlerësuar me notë jokaluese në sesionin e dytë të provimeve kombëtare të arsimit bazë, i ka ridhënë lëndën/lëndët në një nga sesionet e viteve shkollore të ardhshme me testin që japin edhe nxënësit e tjerë të atij viti shkollor.		
Kreu XVI, Neni 96, Pika 3	Nxënësi, që ka mbetur në një ose më shumë lëndë të Maturës Shtetërore, i ka ridhënë ato në vitin/vitet pasardhëse të Maturës Shtetërore, me testin që japin edhe nxënësit e tjerë të atij viti shkollor.		
Kreu XVI, Neni 97, Pika 1	DRAP-i dhe ZVA-ja kanë publikuar të dhënat për provimet e Maturës Shtetërore dhe të provimeve/vlerësimeve kombëtare/ndërkombëtare për shkollat nën juridiksionin e tyre. DRAP-i dhe ZVA-ja kanë marrë të gjitha masat që çdo IA të analizojë rezultatet në bazë të të dhënave të raporteve të		

	QShA-së.		
Kreu XVI, Neni 97, Pika 2	IA-ja ka hartuar raportin në nivel shkolle në lidhje me rezultatet e provimeve/vlerësimeve kombëtare/ndërkombëtare dhe ka marrë masa për sigurimin e cilësisë dhe për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raportet kombëtare.		

## KREU XVII KONKURRIMET E NXËNËSVE

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu XVII, Neni 98, Pika 1, Gërma a	DRAP-i, ZVA-ja dhe IA-të kanë shpallur, në fillim të vitit shkollor, konkurset, sipas përparësive vjetore të tyre, me tema që përfshijnë produktet profesionale të mësuesve, si: projekte ndërlëndore/lëndore, risi të procesit mësimor.		
Kreu XVII, Neni 98, Pika 1, Gërma b	DRAP-i, ZVA-ja dhe IA-të kanë shpallur, në fillim të vitit shkollor, konkurset, sipas përparësive vjetore të tyre, me tema që përfshijnë produkte të nxënësve në artet, sportet, krijimet letrare dhe veprimtari shkencore.		
Kreu XVII, Neni 98, Pika 1, Gërma c	DRAP-i, ZVA-ja dhe IA-të kanë shpallur, në fillim të vitit shkollor, konkurset, sipas përparësive vjetore të tyre, me tema që përfshijnë arritje të IA-ve, si: risi të institucioneve në përkujdesjen ndaj nxënësve në vështirësi ose me prirje të veçanta.		
Kreu XVII, Neni 98, Pika 1, Gërma ç	DRAP-i, ZVA-ja dhe IA-të kanë shpallur, në fillim të vitit shkollor, konkurset, sipas përparësive vjetore të tyre, me tema që përfshijnë zbatimin e TIK-ut në administrimin e institucionit.		
Kreu XVII, Neni 98, Pika 2	IA-ja ka shpallur me ceremoni të posaçme, në fund të vitit shkollor ose në fillim të vitit shkollor pasues, rezultatet e konkurseve.		
Kreu XVII, Neni 99, Pika 1	Olimpiadat kombëtare/ndërkombëtare janë zhvilluar sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim nga ministri përgjegjës për arsimin.		

## KREU XVIII MASA DISIPLINORE

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu XVIII, Neni 100, Pika 1	Nxënësit e të gjitha klasave dhe moshave respektojnë rregullat e disiplinës.		
Kreu XVIII, Neni 100, Pika 2	Rregullat e disiplinës shkollore janë hartuar nga komisioni i disiplinës së shkollës, janë diskutuar me grupet e interesit,		



	janë miratuar nga ZVA-ja dhe janë bërë të njohura në çdo fillimviti shkollor.		
Kreu XVIII, Neni 100, Pika 3	Rregullat e disiplinës dhe masat janë parashikuar në rregulloren e brendshme të IA-së, sipas <i>rregullores tip</i> , të miratuar nga ministri.		
Kreu XVIII, Neni 100, Pika 4	Masat disiplinore të parashikuara në rregulloren e IA-së kanë rol dhe dimension edukativ.		
Kreu XVIII, Neni 100, Pika 5	Komisioni i disiplinës ka trajtuar sjelljet që vijnë në shkelje të rregullave të disiplinës shkollore.		
Kreu XVIII, Neni 100, Pika 6	Masave disiplinore u janë nënshtruar nxënësit që manifestojnë sjellje të papranueshme e të qortueshme, që nuk përputhen me rregullat e disiplinës shkollore, që cenojnë procesin mësimor, misionet pedagogjike, edukative e arsimore dhe që cenojnë klimën miqësore në klasë/shkollë.		
Kreu XVIII, Neni 100, Pika 7	Personeli mësimdhënës i IA-së, gjatë veprimtarisë së tij, ka evidentuar, ka qortuar, ka parandaluar, si dhe ka informuar personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për rastet e shkeljeve të rregullave të disiplinës nga nxënësi.		
Kreu XVIII, Neni 101, Pika 1	IA-ja ka ngritur në fillim të çdo viti shkollor, komisionin e disiplinës, të përbërë nga 5-7 persona.		
Kreu XVIII, Neni 101, Pika 2	Komisioni i disiplinës është i përbërë nga: drejtori i IA-së nëndrejtorët (nëse shkolla ka) dhe mësues të zgjedhur nga këshilli i mësuesve, me shumicë të thjeshtë dhe me votim të fshehtë.		
Kreu XVIII, Neni 101, Pika 3	Komisioni i disiplinës është i kryesuar nga drejtori i IA-së.		
Kreu XVIII, Neni 101, Pika 4	Këshilli i mësuesve, në fillim të vitit shkollor, ka zgjedhur edhe një mësues si anëtar rezervë për komisionin e disiplinës, vetëm për rastet kur mungon njëri prej anëtarëve apo kur çështja që merr në shqyrtim komisioni, lidhet me një prej anëtarëve të tij.		
Kreu XVIII, Neni 101, Pika 5	Komisioni i disiplinës në shkollë i ka marrë vendimet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij dhe me votim të fshehtë.		
Kreu XVIII, Neni 101, Pika 6	Komisioni i disiplinës i IA-së ka shqyrtuar rastet e konstatuara nga komisioni i etikës dhe sjelljes për shkeljet disiplinore të kryera nga nxënësit, mësuesit dhe nëndrejtorët.		
Kreu XVIII, Neni 101, Pika 7	Komisioni i disiplinës i IA-së ka shqyrtuar shkeljet disiplinore (nëse ka) të një anëtari të komisionit të disiplinës, pa praninë e tij.		
Kreu XVIII, Neni 101, Pika 8	Në mbledhjen e komisionit të disiplinës, kur është trajtuar shkelja e rregullave disiplinore nga ana e nxënësit, ka marrë pjesë nxënësi për të cilin shqyrtohet shkelja, mësuesi kujdestar i tij, psikologu apo punonjësi social, si dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tij.		

Kreu XVIII, Neni 101, Pika 9	Çdo nxënës është shoqëruar në mbledhje me një “mbrojtës” të tij, që mund të ketë qenë një person brenda apo jashtë shkollës, i zgjedhur nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit.		
Kreu XVIII, Neni 102, Pika 1	Masa disiplinore është marrë duke respektuar parimin e ligjshmërisë.		
Kreu XVIII, Neni 102, Pika 2	Masa disiplinore është marrë duke respektuar parimin “non bis in idem”.		
Kreu XVIII, Neni 102, Pika 3	Masa disiplinore është marrë duke respektuar parimin e dialogimit.		
Kreu XVIII, Neni 102, Pika 4	Masa disiplinore është marrë duke respektuar parimin e proporcionalitetit.		
Kreu XVIII, Neni 102, Pika 5	Masa disiplinore është marrë duke respektuar parimin e individualizimit.		
Kreu XVIII, Neni 102, Pika 6	Masa disiplinore është marrë duke respektuar parimin e arsyetimit të masës disiplinore.		
Kreu XVIII, Neni 103, Pika 1	IA-ja nuk ka aplikuar masa që cenojnë dinjitetin e nxënësit.		
Kreu XVIII, Neni 103, Pika 2	IA-ja nuk ka aplikuar masa që përfshijnë dhunë të çdo forme.		
Kreu XVIII, Neni 103, Pika 3	IA-ja nuk ka aplikuar masa për përjashtimin e nxënësve pa mbikëqyrës nga mësimi.		
Kreu XVIII, Neni 103, Pika 4	IA-ja nuk ka aplikuar masa për ndalimin e pjesëmarrjes në veprimtaritë shkollore.		
Kreu XVIII, Neni 103, Pika 5	IA-ja nuk ka aplikuar masa për mbajtjen pas mbarimit të mësimin të nxënësit në arsimin fillor.		
Kreu XVIII, Neni 103, Pika 6	IA-ja nuk ka aplikuar masa me gjobë dhe dënime monetare.		
Kreu XVIII, Neni 103, Pika 7	IA-ja nuk ka aplikuar masa disiplinore kolektive për një grup nxënësish.		
Kreu XVIII, Neni 103, Pika 8	IA-ja nuk ka aplikuar masa për sekuestrimin përfundimtar ose për një kohë të gjatë të sendeve personale të ndaluara në shkollë, që u përkasin nxënësve, si: telefonat celularë, aparatura muzikore, video game etj. Mësuesi i ka kërkuar nxënësit t’ia japë atij objektin në fjalë dhe ia ka kthyer atë brenda një kohe “të arsyeshme” (fundi i ditës).		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 3	Masat disiplinore të lehta nuk janë shënuar në karakteristikën e nxënësit, dosjen individuale të tij apo regjistër.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 4, Gërma a	Mësuesi ka dhënë masë disiplinore të lehtë, të parashikuar në rregulloren e brendshme të shkollës, si: shënime në fletore për të cilin është kërkuar nënshkrimi nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika	Mësuesi ka dhënë masë disiplinore të lehtë, të parashikuar në rregulloren e brendshme të shkollës, si: ndjesë para		

4, Gërma b	klasës.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 4, Gërma c	Mësuesi ka dhënë masë disiplinore të lehtë, të parashikuar në rregulloren e brendshme të shkollës, si: dhënia e detyrave shtesë (me konfirmimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, duke u realizuar nën vëzhgimin e mësuesit).		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 4, Gërma ç	Mësuesi ka dhënë masë disiplinore të lehtë, të parashikuar në rregulloren e brendshme të shkollës, si: mbajtja përtej orëve të mësimit të nxënësit të arsimit të mesëm, për të kryer punë në shërbim të shkollës (jo më shumë se një orë dhe me konfirmimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore).		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 4, Gërma d	Mësuesi ka dhënë masa të tjera disiplinore të lehta të parashikuara në rregulloren e brendshme të IA-së.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 5	Përpara marrjes së masës disiplinore të lehtë, nxënësi ka paraqitur versionin e tij të fakteve. Masa disiplinore e lehtë është dhënë në proporcion me shkeljet e kryera dhe të individualizuara.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 6	Masat disiplinore të rënda janë aplikuar vetëm për nxënësit e arsimit të mesëm, për sjellje dhe veprime të rënda dhe të përsëritura, të cilat bien në kundërshtim me rregullat e parashikuara në funksion të procesit mësimor dhe jetës shkollore, në veçanti sjelljet e rënda ndaj personave dhe pronës.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 7	Masat disiplinore të rënda janë shënuar në karakteristikën e nxënësit dhe në dosjen personale.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 8	Masat disiplinore të rënda janë dhënë nga komisioni i disiplinës.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 9	Komisioni i disiplinës, për dhënin e masës disiplinore të rëndë, ka marrë në konsideratë personalitetin e nxënësit, si dhe kontekstin në të cilin është kryer shkelja.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma a	Në masën disiplinore të rëndë është përfshirë “Paralajmërim për ulje të notës në sjellje”.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma a/i	Vendimi “Paralajmërim për ulje të notës në sjellje” është realizuar me shkrim nga komisioni i disiplinës.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma a/ii	Paralajmërimi për ulje të notës në sjellje u është njoftuar me shkrim nxënësit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, apo përfaqësuesit të tij ligjor, të cilët kanë konfirmuar me shkrim njoftimin për masën disiplinore.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma a/iii	Masa disiplinore “Paralajmërimi për ulje të notës në sjellje”, është pjesë e dosjes personale të nxënësit, dhe nëse ka qenë e nevojshme, është shoqëruar nga një masë me natyrë edukative.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika	Në masën disiplinore të rëndë është përfshirë “Ulje e notës		

10, Gërma b	në sjellje”.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma b/i	Vendimi “Ulje e notës në sjellje”, është dhënë vetëm për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma b/ii	Ulja e notës në sjellje u është njoftuar me shkrim nxënësit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore apo përfaqësuesit e tij ligjor, të cilët kanë konfirmuar se kanë marrë njoftim për masën.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma b/iii	Masa disiplinore “Ulje e notës në sjellje” është pjesë e dosjes personale të nxënësit.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma c	Në masën disiplinore të rëndë është përfshirë “Kontribut në shërbim të IA-së apo komunitetit”		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma c/i	Kjo masë disiplinore u është njoftuar nxënësit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tij apo përfaqësuesit ligjor, të cilët kanë konfirmuar se kanë marrë dijëni.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma c/ii	Masa disiplinore “Kontribut në shërbim të IA-së apo komunitetit” ka konsistuar në kontributin e nxënësit jashtë orëve të mësimin, në veprimtari solidariteti, kulturore ose trajnuese, ose në kryerjen e një detyre për qëllime edukimi për një periudhë kohore të përcaktuar nga komisioni i disiplinës, që në total nuk i ka kaluar njëzet orë përgjatë vitit shkollor. Ky kontribut është dhënë brenda iA-së apo një autoritet lokal, të mundësuar nga ZVA-ja.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma c/iii	Masa disiplinore “Kontribut në shërbim të IA-së apo komunitetit” është pjesë e dosjes personale të nxënësit.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma d	Në masën disiplinore të rëndë është përfshirë “Përrjashtim i nxënësit nga IA-ja”.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma d/i	Vendimi “Përrjashtim i nxënësit nga IA-ja” është dhënë vetëm për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë. Kjo masë është dhënë për rastet më ekstreme dhe është aplikuar vetëm pasi komisioni i disiplinës i IA-së ka shfrytëzuar (në mënyrë të shteruar) çdo mënyrë tjetër për të evituar procesin e përrjashtimit, duke i mundësuar nxënësit të dëshmojë vullnetin e tij për të ecur dhe për të reflektuar.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma d/ii	Masa disiplinore “Përrjashtim i nxënësit nga IA-ja” është dhënë vetëm nga komisioni i disiplinës së IA-së.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 10, Gërma d/iii	Njësia administrative bashkiake ku ka vendbanimin nxënësi, është informuar për kohëzgjatjen e masës disiplinore të rëndë për përrjashtim të përrkohshëm ose të përrhershëm nga shkolla, në mënyrë që t’i jepet mundësia për të marrë masat e duhura sociale ose edukative brenda fushëveprimit të kompetencave të saj.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 11	Komisioni i disiplinës i IA-së, kur nuk ka aplikuar menjëherë masën disiplinore të rëndë, ka parashikuar për		

	zbatimin e saj një afat kohor, dhe ka paralajmëruar qartë nxënësin se përsëritja e veprimit nga ana e tij do të çonte në marrjen e vendimit për dhënien e masës përfundimtare.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 12	Komisioni i disiplinës ka vepruar në rastet e dhunës fizike ndaj një mësuesi, edhe kur nuk ka pasur ankesë.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 13	Komisioni i disiplinës ka krijuar një grup arsimor me mësuesit e institucionit, për të zgjidhur një çështje edukative të personalizuar.		
Kreu XVIII, Neni 104, Pika 14	Çdo masë disiplinore u është shpjeguar nxënësit dhe personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, duke u argumentuar atyre qëllimin e marrjes së masës.		
Kreu XVIII, Neni 105, Pika 1	Drejtori i IA-së ka marrë masën e pezullimit ndaj punonjësit arsimor, kur gjykata ka vendosur masë sigurimi personal, deri në ndryshimin e masës.		
Kreu XVIII, Neni 105, Pika 2	Punonjësi arsimor, kur është regjistruar, sipas ligjit, si kandidat për zgjedhjet vendore apo politike, është pezulluar nga puna deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në fund të mandatit.		
Kreu XVIII, Neni 105, Pika 3	Masa e pezullimit ka përfunduar me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra. Punonjësit arsimor të pezulluar i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 1	Titullari i DRAP-it ka ngritur komisionin e disiplinës për shqyrtimin e masave disiplinore për drejtorin e IA-së. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët janë përgjegjësit e sektorëve dhe specialistë të caktuar nga titullari.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 2, Gërma a	Komisioni i disiplinës në DRAP ka marrë masën disiplinore për drejtorin e IA-së, kur ka konstatuar shkelje të dispozitave të Kodit të Punës ose të LAPU-së, të akteve të tjera nënligjore dhe të Rregullores.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 2, Gërma b	Komisioni i disiplinës në DRAP ka marrë masën disiplinore për drejtorin e IA-së kur ka konstatuar shkelje të etikës dhe sjelljes në institucion.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 2, Gërma c	Komisioni i disiplinës në DRAP ka marrë masën disiplinore për drejtorin e IA-së, kur ka konstatuar moskryerje të detyrave, sipas përshkrimit të punës.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 2, Gërma ç	Komisioni i disiplinës në DRAP ka marrë masën disiplinore për drejtorin e IA-së, kur ka konstatuar përsëritje të rezultateve të ulëta të shkollës në provimet kombëtare.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 3, Gërma a	Masa që komisioni i disiplinës ka vendosur për drejtorin është: “Qortim”.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 3, Gërma b	Masa që komisioni i disiplinës ka vendosur për drejtorin është: “Vërejtje”.		

Kreu XVIII, Neni 106, Pika 3, Gërma c	Masa që komisioni i disiplinës ka vendosur për drejtorin është: “Paralajmërim për largim nga puna”.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 4	Për shkeljet e parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 2, të këtij neni nuk është aplikuar masa disiplinore e paralajmërimit për largim nga puna.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 5	Komisioni i disiplinës i DRAP-it ka shqyrtuar marrjen e masave disiplinore ndaj drejtorit të IA-së, me kërkesën me shkrim të DRAP-it ose të ekipit të monitorimit e vlerësimit, ose të mësuesve, të nxënësve të institucionit, të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe të çdo personi që ka hyrë me leje në institucion.		
Kreu XVIII, Neni 106, Pika 6	Në rastet kur drejtori ka ushtruar dhunë ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit dhe këto veprime janë provuar, i është dhënë masë disiplinore “Largim nga detyra”.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 1, Gërma a	Komisioni i disiplinës i IA-së ka dhënë masë disiplinore për mësuesin ose nëndrejtorin, kur ka konstatuar shkelje të legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar, të kësaj Rregulloreje ose të rregullores së brendshme të institucionit.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 1, Gërma b	Komisioni i disiplinës i IA-së ka dhënë masë disiplinore për mësuesin ose nëndrejtorin, kur ka konstatuar shkelje të dispozitave të Kodit të Etikës e të sjelljes në institucion.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 1, Gërma c	Komisioni i disiplinës i IA-së ka dhënë masë disiplinore për mësuesin ose nëndrejtorin, kur ka konstatuar rezultate fiktive të përsëritura të nxënësve, të verifikuara në mënyrë objektive, nëpërmjet testeve të drejtorisë së institucionit ose të DRAP-it apo rezultateve të provimeve kombëtare.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 1, Gërma ç	Komisioni i disiplinës i IA-së ka dhënë masë disiplinore për nëndrejtorin, kur drejtori i shkollës ka konstatuar se nëndrejtori nuk ka kryer detyrat e tij sipas përshkrimit të punës.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 2, Gërma a	Masa e përshkallëzuar që komisioni i disiplinës i IA-së, ka vendosur për mësuesin ose nëndrejtorin, në varësi të llojit të shkeljeve apo përsëritjeve të së njëjtës shkeljeje, është: “Qortim”.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 2, Gërma b	Masa e përshkallëzuar që komisioni i disiplinës i IA-së, ka vendosur për mësuesin ose nëndrejtorin, në varësi të llojit të shkeljeve apo përsëritjeve të së njëjtës shkeljeje, është: “Vërejtje”.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 2, Gërma c	Masa e përshkallëzuar që komisioni i disiplinës i IA-së, ka vendosur për mësuesin ose nëndrejtorin, në varësi të llojit të shkeljeve apo përsëritjeve të së njëjtës shkeljeje, është: “Paralajmërim për largim nga puna”.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 2, Gërma ç	Masa e përshkallëzuar që komisioni i disiplinës i IA-së, ka vendosur për mësuesin ose nëndrejtorin, në varësi të llojit të shkeljeve apo përsëritjeve të së njëjtës shkeljeje, është:		

	“Largim nga puna”.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 3	Në rastin e përsëritjes së shkeljes nga mësuesi/nëndrejtori, i cili për atë shkelje ka marrë më parë masën “Paralajmërim për largim nga puna”, komisioni i disiplinës së IA-së i ka propozuar drejtorit të IA-së fillimin e procedurave për largimin nga puna të mësuesit/nëndrejtorit.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 4	Masa është shlyer kur, për një periudhë gjashtëmujore, komisioni i disiplinës i IA-së nuk ka shqyrtuar shkelje tjetër të mësuesit/nëndrejtorit.		
Kreu XVIII, Neni 107, Pika 5	Në rastet kur mësuesi/nëndrejtori ka ushtruar dhunë ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit dhe këto veprime janë provuar, i është dhënë masë disiplinore “Largim nga detyra”.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 1, Gërma a	Mbarimi i marrëdhënieve të punës së mësuesit me institucionin arsimor publik të arsimit parauniversitar është bërë kur ka dhënë dorëheqjen.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 1, Gërma b	Mbarimi i marrëdhënieve të punës së mësuesit me institucionin arsimor publik të arsimit parauniversitar është bërë kur ka mbushur moshën e pensionit.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 1, Gërma c	Mbarimi i marrëdhënieve të punës së mësuesit me institucionin arsimor publik të arsimit parauniversitar është bërë kur është bërë i paaftë për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike ose mendore, të provuara me raport mjekoligjor.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 1, Gërma ç	Mbarimi i marrëdhënieve të punës së mësuesit me institucionin arsimor publik të arsimit parauniversitar është bërë kur është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për çështje që lidhen me ushtrimin e profesionit.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 1, Gërma d	Mbarimi i marrëdhënieve të punës së mësuesit me institucionin arsimor publik të arsimit parauniversitar është bërë kur është marrë masa disiplinore e largimit nga puna.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 1, Gërma dh	Mbarimi i marrëdhënieve të punës së mësuesit me institucionin arsimor publik të arsimit parauniversitar është bërë kur IA-ja nuk ka ofruar ngarkesë mësimore lëndore.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma a	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka falsifikuar dokumente zyrtare dhe ka bërë deklaratë të rreme në procesin e aplikimit.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma b	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka ushtruar dhunë fizike ndaj nxënësve ose punonjësve të institucionit.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma c	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka ngacmuar seksualisht nxënës ose punonjës të		

	institucionit.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma ç	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka përvetësuar fonde financiare ose materiale të institucionit.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma d	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka organizuar kurse me pagesë me nxënësit që mëson dhe me nxënësit të IA-së.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma dh	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka organizuar kurse me pagesë jashtë IA-së dhe nuk ka qenë i licencuar për të ushtruar këtë veprimtari private.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma e	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka shkelur Kodin e Etikës së mësuesit në institucion.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma ë	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka pasur mosarritje të nxënësve të tij, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 60 të LAPU-së.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma f	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur i është rekomanduar në raportin e monitorimit dhe të vlerësimit.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma g	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka kryer korrupsion pasiv.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma gj	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur ka kryer shkelje të dispozitave të Kodit të Punës dhe të legjislacionit në fuqi.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 2, Gërma h	Drejtori i IA-së ka filluar procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar, kur i është rekomanduar me shkrim nga komisioni i disiplinës së shkollës.		
Kreu XVIII, Neni 108, Pika 3	Procedurat e largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar janë kryer sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe në legjislacionin në fuqi.		

**KREU XIX**  
**DOKUMENTACIONI NË INSTITUCIONET ARSIMORE**

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu XIX, Neni 109, Pika 1	Regjistrat e klasës janë siguruar në sekretari (aty ku ka), ose		



	në zyrën e drejtorit/nëndrejtorit të shkollës.		
Kreu XIX, Neni 109, Pika 2	Regjistrat janë plotësuar dhe janë përdorur në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.		
Kreu XIX, Neni 109, Pika 3	Në periudhën kur regjistri nuk përdoret në klasë, është marrë vetëm nga: a) mësuesi kujdestar i asaj klase; b) mësuesi lëndor i asaj klase; c) monitoruesit që janë duke kryer vlerësimin e jashtëm të IA-së; ç) të tjerë që janë të autorizuar me shkrim nga drejtori i institucionit.		
Kreu XIX, Neni 109, Pika 4	Shkolla ka pajisur me dëftesë të gjithë nxënësit e klasave I-IX dhe të klasave X deri te klasa e parafundit e arsimit të mesëm të lartë.		
Kreu XIX, Neni 109, Pika 5	Dëftesa e klasës dhe ajo e mbarimit të shkollës janë lëshuar vetëm një herë. Shkolla ka pajisur nxënësin/ish-nxënësin me vërtetim të rezultateve të shkollimit, me kërkesë të tij.		
Kreu XIX, Neni 109, Pika 6	Shkolla ka pajisur me certifikatë dhe diplomë të Maturës Shtetërore të gjithë nxënësit që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë. Diploma e Maturës Shtetërore është lëshuar vetëm një herë.		
Kreu XIX, Neni 109, Pika 7	Drejtori i shkollës është kujdesur me përgjegjësi për ruajtjen e amzës, si dhe mban në vend të siguruar amzën e shkollës.		
Kreu XIX, Neni 109, Pika 8	Amza është plotësuar dhe përdorur në përputhje me udhëzimet që jepen në faqen e parë të saj. Në IA-të ku është krijuar amza digjitale, personi përgjegjës për administrimin e saj është mësuesi (ose dy mësues për shkollat e mëdha) që jep lëndën e TIK/informatikës në shkollë, i cili është caktuar me urdhër të drejtorit. Amza digjitale përmban të gjithë informacionin që ka amza e shkollës. Plotësimi i amzës digjitale është kryer sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.		
Kreu XIX, Neni 109, Pika 9	Regjistri i veçantë, amza dhe indeksi i amzës së shkollave të mbyllura janë dorëzuar nga drejtori i IA-s, nën kujdesin e ZVA-së përkatëse në arkivin vendor, menjëherë me hyrjen në fuqi të aktit të mbylljes.		

**KREU XX**  
**BIBLIOTEKA E INSTITUCIONIT ARSIMOR**

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu XX, Neni 110, Pika 1	Biblioteka e institucionit arsimor ka qëndruar e hapur edhe pas përfundimit të orarit mësimor.		

Kreu XX, Neni 110, Pika 2	Lexuesit e bibliotekës janë nxënësit dhe mësuesit e shkollës. Përfshirjet janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të IA-së.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 3	Kujdestar i bibliotekës është caktuar një mësues i institucionit arsimor i profilit “Gjuhë shqipe dhe letërsi”.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 4, Gërma a	Drejtori i institucionit ka miratuar rregulloren e bibliotekës, e cila është hartuar nga një grup pune i përbërë nga mësues dhe nxënës.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 4, Gërma b	Drejtori i institucionit ka miratuar përshkrimin e punës së kujdestarit të bibliotekës.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 4, Gërma c	Drejtori i institucionit ka caktuar orarin ditor të funksionimit të bibliotekës.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 5, Gërma a	Kujdestari i bibliotekës ka siguruar shërbimin e bibliotekës për lexuesit e saj.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 5, Gërma b	Kujdestari i bibliotekës ka klasifikuar dhe ka përpunuar në baza shkencore librat e bibliotekës dhe i ka inventarizuar ata.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 5, Gërma c	Kujdestari i bibliotekës ka informuar rregullisht lexuesit për prurjet e reja në bibliotekë.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 5, Gërma ç	Kujdestari i bibliotekës ka bashkëpunuar me punonjësit arsimorë të institucionit dhe nxënësit për pasurimin e bibliotekës.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 5, Gërma d	Kujdestari i bibliotekës ka zhvilluar vetë veprimtari të bibliotekës, ose në bashkëpunim me punonjësit arsimorë të institucionit ose të ftuar.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 6	Në bibliotekë janë të ruajtura kopjet e këtyre dokumenteve: Kodi i Punës, LAPU, Rregullorja, Kontrata Kolektive, dokumentet kurrikulare të miratuara nga ministri.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 7, Gërma a	Në bibliotekë janë të ruajtura koleksione e botime të ministrisë dhe të institucioneve në varësi të saj.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 7, Gërma b	Në bibliotekë është i ruajtur historiku i IA-së.		
Kreu XX, Neni 110, Pika 7, Gërma c	Në bibliotekë janë të ruajtura tekstet shkollore alternative të dhëna nga shtëpitë botuese ose të blera nga IA-ja.		

**KREU XXI**  
**SHËNDETI, SIGURIA, MIRËMBAJTJA E IA-SË**

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu XXI, Neni 111, Pika 1	Drejtori i IA-së ka ngritur komisionin e shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit, të kryesuar prej tij ose një nëndrejtor i ngarkuar prej tij (nëse ka), të përbërë nga		

	mësues të zgjedhur nga këshilli i mësuesve, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit, të caktuar nga këshilli i prindërve, si dhe nxënës nga qeveria e nxënësve.		
Kreu XXI, Neni 111, Pika 2, Gërma a	Komisioni ka mbikëqyrur rregullisht në IA kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve, si dhe mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve.		
Kreu XXI, Neni 111, Pika 2, Gërma b	Komisioni ka identifikuar nevojat për mirëmbajtje të institucionit.		
Kreu XXI, Neni 111, Pika 2, Gërma c	Komisioni ka përcaktuar nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve.		
Kreu XXI, Neni 111, Pika 2, Gërma ç	Komisioni ka organizuar veprimtari ndërgjegjësuere me nxënës, mësues dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit, për kushtet e ruajtjes së shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.		
Kreu XXI, Neni 111, Pika 2, Gërma d	Komisioni ka hartuar raporte për drejtorin e IA-së për kushtet e parashikuara në shkronjën “a” të kësaj pike dhe ka propozuar përmirësime.		
Kreu XXI, Neni 111, Pika 3	Komisioni ka propozuar procedurat ditore dhe javore të higjienës, pastërtisë dhe mirëmbajtjes së IA-së, të cilat janë miratuar nga drejtori i institucionit.		
Kreu XXI, Neni 111, Pika 4	Komisioni ka drejtuar hartimin e rregullores, që përmban: a) veprimet konkrete që kryhen në raste emergjence; b) procedurat e pranimit të njerëzve të panjohur në mjediset e institucionit; c) procedurat e mirëmbajtjes rutinë ditore dhe javore të IA-së; ç ) të tjera, me propozimin e mësuesve, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit dhe vetë nxënësve.		
Kreu XXI, Neni 111, Pika 5	Drejtori i IA-së ka miratuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit.		
Kreu XXI, Neni 112, Pika 1, Gërma a	Drejtori i IA-së ka njoftuar menjëherë urgjencën shëndetësore, kur është nevojitur ndihma e saj.		
Kreu XXI, Neni 112, Pika 1, Gërma b	Drejtori i IA-së ka dërguar menjëherë me mjete të transportit të rastit nxënësin ose punonjësin e IA-së, kur urgjenca shëndetësore e ka porositur të veprojë ashtu.		
Kreu XXI, Neni 112, Pika 2	Mësuesi kujdestar ose drejtuesi i IA-së ka njoftuar menjëherë personin që ushtron përgjegjësinë prindërore, kur një nxënës është sëmurur ose ka pësuar aksident.		
Kreu XXI, Neni 112, Pika 3	Institucioni arsimor ka siguruar të paktën kutinë e ndihmës së parë, përherë funksionale. Të paktën, një mësues për 400 nxënës është certifikuar për		

	<p>administrimin e ndihmës së parë.</p> <p>Për aksidente të vogla, nxënësi i dëmtuar ka marrë ndihmën e parë në shkollë.</p>		
Kreu XXI, Neni 112, Pika 4	<p>Drejtori i IA-së nuk ka lejuar që të hyjnë në mjediset mësimore punonjësit ose nxënësit që kanë sëmundje ngjitëse, të vërtetuara me raporte mjekësore.</p> <p>Drejtori i IA-së ka njoftuar shërbimin shëndetësor, kur është dyshuar për përhapjen e një sëmundjeje ngjitëse në institucion.</p>		
Kreu XXI, Neni 112, Pika 5	<p>Pirja e duhanit dhe e alkoolit është e ndaluar në të gjitha mjediset e institucionit.</p> <p>Institucioni ka arritur marrëveshje me institucionet e tjera për ndalimin e pirjes së duhanit në mjediset ku nxënësit kryejnë veprimtari.</p>		
Kreu XXI, Neni 112, Pika 6	<p>Drejtori i IA-së ka siguruar dokumentet, sipas legjislacionit në fuqi, për ruajtjen e shëndetit të nxënësve nga artikujt që tregtohen për ta brenda territorit të institucionit ose pranë institucionit, por që shesin edhe për nxënësit.</p>		
Kreu XXI, Neni 112, Pika 7	<p>Drejtori i IA-së ka njoftuar autoritetet përkatëse kur janë krijuar zhurma që shpërqendrojnë vëmendjen e nxënësve.</p>		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 1	<p>IA-ja ka afishuar në vend të dukshëm numrat e emergjencës (numrat e policisë, të zjarrfikëseve, të urgjencës).</p>		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 2	<p>Punonjësit e institucionit dhe nxënësit janë udhëzuar dhe stërvitur për radhën e veprimeve në godinën e institucionit, për ngjarje të jashtëzakonshme, si: rënie zjarri, përmytje, tërmete etj.</p>		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 3, Gërma a	<p>IA-ja ka pajisjet e mjaftueshme për mbrojtjen kundër zjarrit.</p>		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 3, Gërma b	<p>IA-ja ka shenja dalluese që tregojnë rrugën për të dalë në raste ngjarjesh të jashtëzakonshme.</p>		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 4	<p>Korridorët, shkallët dhe sheshpushimet në godinën e IA-së nuk janë zënë me objekte që pengojnë lëvizjen, në raste ngjarjesh të jashtëzakonshme.</p>		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 5	<p>Drejtori i IA-së publike ka komunikuar me NjVV-në, kur ka qenë në rrezik siguria në institucion, për shkak të problemeve në mirëmbajtjen e tij.</p>		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 6	<p>Mësuesit janë kujdesur për sigurinë e mjeteve dhe të pajisjeve që përdoren nga nxënësit.</p> <p>Në një vend të dukshëm për nxënësit janë vendosur rregulloret e sigurisë në mjediset e shkollës, si: laboratorë, palestër.</p> <p>Nxënësit i kanë përvetësuar rregulloret.</p>		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 7	<p>Drejtori i IA-së, kur ka gjykuar se rrezikohet siguria në një mjedis ose në të gjithë ndërtesën, ka vendosur ndërprerjen e funksionimit të mjedisit ose të institucionit, dhe ka</p>		

	njoftuar menjëherë bashkinë dhe ZVA-në.		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 8	Drejtori i IA-së ka hartuar raportin për çdo rast emergjence në institucion.		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 9	Drejtori i IA-së publike ka formuluar periodikisht për njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, kërkesën e detajuar për mirëmbajtjen e institucionit, bazuar në pyetësonin e mirëmbajtjes.		
Kreu XXI, Neni 113, Pika 10	Drejtori i IA-së ka njoftuar policinë dhe bashkinë për vjedhje ose tentativë vjedhjeje në pronën e institucionit.		
Kreu XXI, Neni 114, Pika 1	Drejtori/nëndrejtori i IA-së, për dëmtimin/vjedhjen e pronës publike në IA nga punonjësit/nxënësit e institucionit, ka hartuar procesverbalin, ku përshkruan ngjarjen dhe dëmin. Mësuesi kujdestar ka njoftuar personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit.		
Kreu XXI, Neni 114, Pika 2	Drejtori i IA-së publike ka dërguar zyrtarisht në NjVV procesverbalin për dëmtimin e shkaktuar, bashkë me emrin e dëmtuesit/dëmtuesve. Kur dëmtuesi ka qenë nxënës, drejtori ka dhënë edhe emrat e personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit dhe adresat e tyre.		
Kreu XXI, Neni 114, Pika 3	NjVV-ja, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi, ka përcaktuar masën e zhdëmtimit dhe ka njoftuar zyrtarisht dëmtuesin.		
Kreu XXI, Neni 114, Pika 4	Punonjësi arsimor/personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit ka likuiduar detyrimet për dëmin e shkaktuar me përfitues NjVV-në.		
Kreu XXI, Neni 114, Pika 5	IA-ja private ka përcaktuar në rregulloren e saj të brendshme procedurat e zhdëmtimeve.		

**KREU XXII**  
**RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT TË IA-SË, TROFEVE, HISTORIKUT E**  
**ALBUMEVE. INVENTARI**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu XXII, Neni 115, Pika 1	IA-ja ruan përgjithmonë në arkiv këto dokumente: amzën e shkollës dhe indeksin alfabetik të amzës; evidencat e treguesve antropometrikë dhe cilësive fizike të nxënësve; planet dhe programet mësimore; regjistrin e veçantë ku nënshkruajnë nxënësit që marrin dëftesën e arsimit bazë, certifikatën dhe diplomën e Maturës Shtetërore; procesverbalin e korrigjimeve në amzë, në indeksin e saj dhe në regjistrin e veçantë; librin “Historiku i kopshtit/shkollës”; albumet me fotografi me veprimtaritë e		

	IA-së; evidencat statistikore; protokollet/procesverbalet e akteve zyrtare.		
Kreu XXII, Neni 115, Pika 2	IA-ja ka dorëzuar në arkivin shtetëror vendor, që vepron brenda njësisë administrativo-territoriale ku ndodhet IA-ja, dokumentet administrative, të parashikuara në ligjin për arkivat, pasi kanë kaluar 10 vjet nga data e krijimit të tyre.		
Kreu XXII, Neni 115, Pika 3	<p>IA-ja ka të ruajtura për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 vjet inventarin vjetor të saj;</li> <li>- 8 vjet dokumentet e shpenzimeve financiare;</li> <li>- 8 vjet dokumentet e punësimit dhe të largimit të punonjësve të tij;</li> <li>- 4 vjet fletoren e kontingjenteve të nxënësve;</li> <li>- 6 vjet korrespondencën zyrtare të drejtorit;</li> <li>- 4 vjet procesverbalet e mbledhjeve të drejtorisë dhe të këshillit të mësuesve;</li> <li>- 4 vjet dokumentacionin që pasqyron lëvizjet e nxënësve;</li> <li>- 2 vjet ankesat me shkrim që i drejtohen drejtorit nga nxënës, prindër, qytetarë dhe përgjigjet e drejtorit;</li> <li>- 2 vjet propozimet me shkrim që i drejtohen drejtorit nga nxënës, prindër, qytetarë;</li> <li>- 2 vjet dokumentet e shpërblimit dhe lavdërimit të punonjësve;</li> <li>- 2 vjet procesverbalet e komisioneve të provimeve me bazë shkolle;</li> <li>- 2 vjet përgjigjet me shkrim të nxënësve në provimet me bazë shkolle;</li> <li>- 2 vjet punimet e nxënësve në konkurset e pranimit në shkollat me konkurse;</li> <li>- 2 vjet dokumentet që pasqyrojnë veprimtaritë plotësuese;</li> <li>- 4 vjet dosjen e nxënësit, të hartuar nga psikologu/punonjësi social;</li> <li>- 4 vjet planin vjetor të zhvillimit të brendshëm profesional të institucionit;</li> <li>- 5 vjet evidencat dhe informacionet periodike, të përfshira në përmbledhëse, korrespondence etj.;</li> <li>- 8 vjet planin afatmesëm;</li> <li>- 4 vjet planin vjetor të IA-së;</li> <li>- 4 vjet raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm;</li> <li>- 10 vjet regjistrin e klasës;</li> <li>- deri në shfuqizimin e tyre, ligje dhe VKM për nivelin arsimor të institucionit, akte nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, dokumentacion kurrikular.</li> </ul>		

Kreu XXII, Neni 115, Pika 4	IA-ja ka të ruajtur në një vend të posaçëm trofetë që ka fituar në veprimtari të ndryshme të saj, si: dekorata, diploma, flamuj, kupa etj.		
Kreu XXII, Neni 116, Pika 1	IA-ja publike ka librin e tij të inventarit që përmban pajisjet dhe mjetet mësimore që hyjnë në institucion. Çdo mjet me vlerë që ka hyrë në IA (i blerë, i dhuruar) është bërë me dokumentacion të rregullt dhe është inventarizuar menjëherë nga komisioni i përbërë nga drejtori i IA-së dhe dy mësues të përzgjedhur me votim të fshehtë nga këshilli i mësuesve.		
Kreu XXII, Neni 116, Pika 2	Komisioni, në të cilin bën pjesë drejtori i institucionit dhe përfaqësuesi i organit administrativ të NjVV-së, ka kryer kalimin e pajisjeve ose mjeteve mësimore në inventarin e institucionit, duke nënshkruar dokumentacionin përkatës.		
Kreu XXII, Neni 116, Pika 3	Për heqjen nga inventari të mjeteve mësimore dhe pajisjeve janë mbajtur parasysh normat e konsumit dhe garancisë. Heqja nga inventari i artikujve të caktuar është dokumentuar nga komisioni i ngritur nga NjVV-ja dhe drejtori i IA-së.		
Kreu XXII, Neni 116, Pika 4	Komisioni, i ngritur nga drejtori i IA-së, në çdo vit kalendarik, ka kryer inventarin e mjediseve të institucionit, i cili është nënshkruar nga kryetari i komisionit dhe personi që përgjigjet për mjedisin përkatës.		
Kreu XXII, Neni 116, Pika 5	Organi administrativ prej të cilit varet institucioni, ka kryer çdo vit me komision inventarin, duke mbajtur një kopje të tij. Sekretari i shkollës ose në mungesë të tij drejtori i IA-së, ka mbajtur inventarin e institucionit.		
Kreu XXII, Neni 116, Pika 6	Dorëzimi i inventarit nga njëri mësues te tjetri dhe nga një drejtor te tjetri është bërë me procesverbal.		
Kreu XXII, Neni 116, Pika 7	Drejtori është kujdesur (ka përgjegjësi ligjore) për ruajtjen e inventarit.		

**KREU XXIII**  
**INSTITUCIONET ARSIMORE VENDORE, PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN**  
**PARAUNIVERSITAR**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu XXIII, Neni 117, Pika 1	Vëzhgimet e kryera në institucionet arsimore nga institucionet arsimore vendore, kanë pasur si objekt veprimtarinë e drejtuesve të IA-së dhe të mësuesve.		
Kreu XXIII, Neni 117, Pika 1	Bazuar në raportet përmbledhëse të vëzhgimeve, titullari i ZVA-së i ka propozuar titullarit të DRAP-it masa administrative ndaj drejtorit të institucionit arsimor të		

	vëzhguar, si dhe i ka propozuar drejtorit të IA-së marrjen e masave administrative ndaj mësuesve.		
--	---	--	--

**KREU XXV**  
**DISPOZITAT KALIMTARE**

<b>Baza ligjore</b>	<b>Përshkruesit praktikë</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Komente</b>
Kreu XXV, Pika 1	Procedurat e përzgjedhjes së teksteve shkollore në përdorim falas, porositja, shpërndarja dhe grumbullimi, janë kryer sipas kuadrit ligjor në fuqi.		
Kreu XXV, Pika 2	Arsimimi i detyrueshëm jashtë institucioneve arsimore, si në kushtet e shtëpisë, arsimimi për individët e moshës shkollore në institucionet e paraburgimit, të vuajtjes së dënimit dhe në institucionet e përkujdesjes shoqërore, janë ofruar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi		
Kreu XXV, Pika 3	Institucioni arsimor është organizuar dhe zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore në fuqi.		
Kreu XXV, Pika 4	Institucioni arsimor ka rregulloren e brendshme, të hartuar në përputhje me rregulloren tip të miratuar nga ministri.		
Kreu XXV, Pika 5	ZVA-të dhe IA-të kanë realizuar kartën e performancës të institucionit në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit.		
Kreu XXV, Pika 6	Veprimtaria e IA-së si qendër komunitare, është zhvilluar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.		
Kreu XXV, Pika 7	Emërimi, largimi nga puna i psikologut/punonjësit social dhe oficerit të sigurisë në institucionin arsimor është bërë në përputhje aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kreu XXV, Pika 8	Punonjësit e shërbimeve mbështetëse në IA janë punësuar dhe larguar nga puna nga NjVV-ja.		
Kreu XXV, Pika 9	Ndjekja e arsimit bazë me kohë të pjesshme, e gjimnazit me kohë të pjesshme dhe e gjimnazit në distancë është kryer sipas udhëzimeve të posaçme të nxjerra nga ministri.		